



**MBROJTJA E FËMIJËVE
DHE E TË RRITURVE TË CENUESHËM**

Politikë tip dhe Udhëzues praktik

PASQYRA E LËNDËS

1. HYRJE

1.1 Çfarë është politika e mbrojtjes?	4
1.2 Cila është baza biblike?	5
1.3 Mirënjohje	8

2. POLITIKA E MBROJTJES

2.1 Kuadri ligjor.	10
2.2 Përkufizime dhe llojet e abuzimit	11
2.2.1 Treguesit e abuzimit	13
2.2.2 Parandalimi	16
2.3 Personi i caktuar për mbrojtjen.	17
2.3.1 Raportimi i akuzave për abuzim	18
2.3.2 Veprimi disiplinor	19
2.4 Kodi i sjelljes për çdo staf/vullnetar	21

3. UDHËZIMET DHE PROCEDURAT

3.1 Udhëzimet dhe procedurat standarde	24
3.2 Udhëzime rrethore specifike.	32

4. BURIMET

4.1 Lidhje të dobishme	35
4.2 Ligji shqiptar	35
4.3 Grafik rrjedhës i veprimeve për t'u ndërmarrë në raste të mbrojtjes së fëmijës	36
4.4 Lista e organizatave dhe strehave që punojnë me viktimat e dhunës në familje dhe numrat falas të linjave ndihmëse	37
4.5 Kutia e ndihmës së shpejtë.	39

5. FORMULARË TË GATSHËM, TË DOBISHËM PËR PËRDORIM

5.1 Formulari i aksidenteve / incidenteve	41
5.2 Formulari i pretendimit	42
5.3 Formulari i referimit për mbrojtjen e fëmijës	43
5.4 Formular miratimi për fëmijën	44
5.5 Formulari për staf dhe vullnetarë.	45



-1-
Hyrje

1.1 ÇFARË ËSHTË POLITIKA E MBROJTJES?

Politika e Mbrojtjes është një dokument dhe një procedurë që një organizatë/kishë/kamp, qendër/komunitet, qendër/strehë rezidenciale duhet të ketë për të ndihmuar në parandalimin e abuzimit të mundshëm të fëmijëve/të rriturve të cenueshëm, si dhe mbrojtjen e tyre. Kjo politikë synon:

- t'i tregojë stafit se cila është sjellja e përshtatshme që pritet prej tyre në organizatë;
- të mbrojë stafin nga akuza të rreme që mund të ngrihen kundër tyre;
- të mësojë stafin se si mund të sillen me fëmijët/të rriturit e cenueshëm dhe veçanërisht kur ata u tregojnë atyre për një incident abuzimi;
- të sigurojë që stafi brenda një organizate i di hapat që duhen marrë për të raportuar dyshimet për një incident abuzimi, si dhe masat e nevojshme që duhen ndërmarrë.

Pse na nevojitet një politikë mbrojtjeje?

- Për të mbrojtur fëmijët/të rriturit e cenueshëm - abuzimi shkatërron jetë.
- Për të mbrojtur stafin tuaj - një akuzë e rreme mund të shkatërrojë jetën e tyre.
- Për të mbrojtur shërbesën e organizatës/institucionit tuaj.
- Për të nderuar emrin e Jezusit dhe kishën.

Aktualisht, Shqipëria ka ligje në fuqi mbi mbrojtjen e fëmijëve¹, ndaj të cilave kishat, organizatat dhe individët që punojnë me fëmijët/të rriturit e cenueshëm, mund të mbahen përgjegjës.

Cili është qëllimi?

Kjo politikë u zhvillua për të pajisur komunitetin fetar, konkretisht Kishën Ungjillore të Shqipërisë me një standard universal të parimeve që duhen mbajtur dhe zbatuar, kur flitet për sigurinë dhe mbrojtjen e fëmijëve dhe të rriturve të cenueshëm të cilëve ne u shërbejmë. Ky dokument është i pari në llojin e tij në Shqipëri dhe shërben jo vetëm për të mbrojtur fëmijët, por edhe për të dhënë parime udhëzuese që do të mbrojnë stafin/vullnetarët, si edhe kishën/komunitetin fetar.

Politika e mbrojtjes është krijuar në mënyrë të tillë që të shërbejë si model që mund të përshtatet nga çdo kishë apo organizatë fetare, në mënyrë që të përkojë me gamën e veprimtarive të organizatës/institucionit të tyre.

Rekomandohet fort që ky dokument të arrihet lehtë dhe të ndahet me të gjithë stafin/vullnetarët që punojnë me fëmijët dhe të rriturit e cenueshëm në organizatën tuaj. Synimi

¹ Ligji Nr. 10 347, datë 4.11.2010: "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës VKM Nr. 263, datë 12.04.12"

është që çdo kishë/organizatë të firmosë se bie dakord të zbatojë politikën e mbrojtjes dhe që ajo të rishikohet herë pas here në takime të stafit, trajnime para aktiviteteve të ndryshme etj.

Cilat janë vlerat?

Vlerat mbi të cilat mbështetet kjo politikë janë si më poshtë:

Interesi më i mirë i fëmijës/të rriturit të cenueshëm

Interesi më i mirë i fëmijës/të rriturit të cenueshëm do të thotë të merren parasysh nevojat, mendimet dhe mirëqenia e tyre para se të merret një vendim që i prek ata direkt ose indirekt.

Mirëqenia e fëmijës

Prindërit, kujdestarët, stafi dhe vullnetarët që kanë fëmijë/të rritur të cenueshëm në kujdesin e tyre duhet të bëjnë gjithçka që mundën për të siguruar mirëqenien e tyre dhe për të parandaluar çdo lloj abuzimi.

Mirëbesimi

Marrëdhënia e fëmijës me prindërit, kujdestarët, stafin dhe vullnetarët duhet të ketë në qendër mirëbesimin, në mënyrë që fëmija të ndihet i qetë, duke ditur se ky person nuk do ta dëmtojë atë. Mirëbesimin i pranon rregullat, hirearkinë dhe ligjet, si dhe sanksionon shtegun e duhur për të punuar me fëmijët/të rriturit e cenueshëm.

Ruajtja e konfidencialitetit

Identiteti dhe të dhënat e fëmijëve/të rriturve të cenueshëm duhet të mbrohen dhe të ruhen në mirëbesim. Stafi që punon me fëmijët/të rriturit e cenueshëm duhet ta respektojë mirëbesimin si një vlerë të rëndësishme.

Komunikimi i hapur

Prindërit, kujdestarët, stafi dhe vullnetarët duhet të kenë komunikim të hapur me fëmijët/të rriturit e cenueshëm, gjë që shërben si urë për të ndërtuar marrëdhënie e për të zgjidhur konflikte e mosmarrëveshje.

1.2 CILA ËSHTË BAZA BIBLIKE?

Ndërkohë që Bibla nuk është një manual mbrojtjeje, gjithsesi ajo përmban disa çështje në shkrim, të cilat na ndihmojnë të kuptojmë mendjen e Zotit dhe na siguron një bazë për standarde, parime dhe teologji për gjithçka që ne bëjmë.

Teologjia e mbrojtjes nis me të vetmin atribut të Perëndisë që jepet si më dalluesi në Shkrimet e Shenjta, pra, **dashuria e Tij e palëkundur**, saqë bëhet një temë gjithëpërfshirëse e Dhjatës së Vjetër dhe asaj të Re.

Në këtë botë të trazuar, **dashuria** e Perëndisë është **strehë sigurie**, veçanërisht për të vegjlit, të dobëtit, të varfërit, e aq më tepër për fëmijët dhe të cenueshmit. Perëndia e ka pasion **drejtësinë**. Shkrimet janë plot me raste ku Perëndia shpëton të braktisurit, u jep hir të shtypurve, lartëson të përlururit dhe u jep zë atyre që nuk kanë. (*Psalmi 72:4, 12-14; 146:7, 9*).

Temat e dashurisë, mbrojtjes dhe drejtësisë mblidhen bashkë në Perëndinë si Atë, duke qenë se Ai është Ati ynë qiellor. Dashuria, kujdesi, ushqimi dhe mbrojtja që u jep fëmijëve të Tij Perëndia Atë, është modeli i vërtetë i atësisë.

Për ne si Kishë, është e rëndësishme të sigurohemi që praktikat tona të përmbushin standardet më të larta që priten nga Zoti ynë dhe pjesa tjetër e shoqërisë. Në këtë mënyrë Kisha tregon dashurinë, mbrojtjen dhe drejtësinë e Atit dhe të duash të tjerët porsì vetveten (*Mateu 22:36-40*).

Shkrimet na thonë: *“Mbroni të dobëtin dhe jetimin, sigurojini drejtësinë të vuajturit dhe të varfrit. Çlironi të mjerin dhe nevojtarin; shpëtojeni nga dora e të pabesit.”* (*Psalmi 82:3-4*).

Një Perëndi i dashur

Tregimi biblik i krijimit të racës njerëzore sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë, *“Imago Dei”*, jep një bazë të fortë për vlerësimin e çdo jete njerëzore, përfshi çdo fëmijë e çdo të rritur të cenueshëm. Perëndia e konfirmoi dashurinë e Tij për çdo burrë, grua dhe fëmijë, duke dhënë Jezus Krishtin, që përmes vdekjes dhe ringjalljes së Tij çdo njeri që beson në Të, të ketë një marrëdhënie personale me Të.

Trajtimi që u bëri Jezusi fëmijëve dhe mësimet e Tij për Mbretërinë e Perëndisë i sfiduan rrënjësisht kuptimet e mëparshme të statusit të fëmijëve. Mësimi i Tij është përgjigje e drejtpërdrejtë ndaj pyetjes së dishepujve në lidhje me pushtetin dhe autoritetin. Ata pyetën: *“Kush është, pra, më i madhi në mbretërinë e qiejve?”* Dhe Jezusi, pasi thirri një fëmijë të vogël pranë vetes, e vuri në mes tyre dhe tha: *“Në të vërtetë po ju them: në qoftë se nuk ktheheni dhe të bëheni si fëmijët a e vegjël, nuk do të hyni fare në mbretërinë e qiejve. Kush, pra, do ta përlulë veten si ky fëmijë i vogël, ai do të jetë më i madhi në mbretërinë e qiejve. Dhe kushdo që e pranon një fëmijë të vogël si ky në emrin tim, më pranon mua.”* (*Mateu 18:1-5*)

Në kishat tona ne kemi anëtarë fëmijë dhe të rritur të cenueshëm të cilëve u shërbejmë dhe kanë nevojë për kujdesin dhe përkushtimin tonë. Ne duhet ta marrim seriozisht porosinë e dhënë nga Jezusi për t'i mirëpritur fëmijët (*Luka 9:48²*, për t'i mbrojtur ata (*Mateu 18:6-10*)³ e për t'i lejuar të vijnë të lirë tek Ai (*Marku 10:13-16*)⁴.

Një botë e rënë

Domethënia e doktrinës së mëkatit origjinal është se gjendja mëkatore e njeriut erdhi si pasojë e mëkatit të Adamit në Kopshtin e Edenit. Të gjitha aspektet e personalitetit dhe

2 *Luka 9:48*: “...dhe u tha atyre: “Ai që e pranon këtë fëmijë të vogël në emrin tim, më pranon mua; dhe ai që më pranon mua, pranon atë që më dërgoi mua, sepse ai që është më i vogli nga ju të gjithë, ai do të jetë i madh.”

3 *Mateu 18: 6-10*: Por ai që do të skandalizojë një prej këtyre të vegjëlve që besojnë tek unë, do të jetë më mirë për të t'i varet në qafë një gur mulliri (që e sjell rrotull gomari) dhe të zhytet në thellësi të detit. Mjerë bota për skandalet! Sepse është e nevojshme të vijnë skandalet, por mjerë ai njeri përmes të cilit do të vijë skandali! Tani në qoftë se dora jote ose këmba jote të shtyn në mëkat, preje dhe hidhe prej teje; është më mirë për ty të hysh në jetë dorëçung ose i çalë, sesa të kesh dy duar dhe dy këmbë dhe të hidhesh në zjarr të përjetshëm. Po ashtu, në qoftë se syri yt të shtyn në mëkat, nxirre dhe hidhe prej teje; është më mirë për ty të hysh në jetë vetëm me një sy sesa t'i kesh të dy sytë dhe të të hedhin në ferr të zjarrit. Ruhuni se përbuzni ndonjë nga këta të vegjlit, sepse po ju them se engjëjt e tyre në qiej shohin vazhdimisht fytyrën e Atit tim, në qiej.

4 *Marku 10:13-16*: “Atëherë i prunë disa fëmijë të vegjël që ai t'i prekte ata; por dishepujt i qortonin ata që i prunë. Kur Jezusi e pa këtë, i indinjuar, u tha atyre: “I lini fëmijët e vegjël të vijnë tek unë dhe mos i pengoni, sepse për të tillë është mbretëria e Perëndisë. Në të vërtetë po ju them se kushdo që nuk e pranon mbretërinë e Perëndisë si një fëmijë i vogël, nuk do të hyjë në të”. Dhe, si i mori në krahë, i bekoj duke vënë duart mbi ta.”

kulturës njerëzore janë infektuar nga ky mëkat, veçanërisht egoizmi. Tek Romakëve 5:12 thuhet: *“Prandaj, ashtu si me anë të një njeriu a të vetëm mëkati hyri në botë dhe me anë të mëkatit vdekja, po ashtu vdekja i arriti të gjithë njerëzit, sepse të gjithë mëkatuan.”* Kjo është e vërtetë si në nivelin ndërpersonal, ashtu edhe brenda strukturave autoritare të shoqërisë. Mbrojtja nënkupton se brenda shoqërisë njerëzore ka gjasa të abuzohet me pushtetin, çka do të thotë se fëmijët dhe të cënueshmit janë në rrezik.

Jezusi i paralajmëron fort dishepujt për rreziqet e “skandalizimit të njërit prej këtyre të vegjëlve që besojnë në Mua”. “Të vegjlit” këtu mund të nënkuptojë jo vetëm fëmijët, por edhe të gjithë personat e cënueshëm të cilët ndihen ‘të vegjël’ dhe të pafuqishëm për të mbrojtur vetveten.

Edhe pse besojmë se Perëndia është Mbrojtësi ynë, e keqja është e pranishme në botën tonë dhe ne jemi të thirrur *“të kujdesemi, pra, që të ecim me kujdes dhe jo si të marrët, por si të mençurit”* (Efesianëve 5:15). Te Fjalët e Urta 14:16 thuhet: *“I urti i trembet së keqes dhe largohet prej saj, por budallai e tepron dhe është fodull.”* Te Mateu 10:16, shkruhet që Jezusi i nisi dishepujt duke u thënë: *“Ja, Unë po ju dërgoj si dele në mes të ujqërve; jini, pra, të mençur si gjarpërinjtë dhe të pastër si pëllumbat.”* Thirrja për ne është që të jemi të mençur në shërbimin tonë ndaj Zotit, prandaj zbatimi i procedurave të mbrojtjes në shërbesën tonë dhe mbrojtja e mëtejshme e të cënueshmëve të cilëve u shërbejmë në këtë botë të rënë është një praktikë e mençur.

Përfundim

Perëndia, që është Ati ynë dhe shembulli i përsosur i dashurisë dhe drejtësisë, na ka thirrur ta duam njëri-tjetrin e të kërkojmë drejtësinë. Jezusi e bëri të qartë se fëmijët dhe personat e cënueshëm duhen respektuar, vlerësuar dhe mbrojtur. Ne nuk duhet të bëjmë kompromise në vendosmërinë tonë, për të mos lejuar që askush brenda Kishave dhe aktiviteteve tona të lëndohet.

Mbrojtja e fëmijëve dhe personave të cënueshëm është detyrim nga Ungjilli, ndaj mirëqenia e tyre është thelbësore për shërbesën tonë. Për këto arsye biblike, bashkë me detyrimet tona ligjore për sa kohë fëmijët janë nën kujdesin tonë, indiferenca ose neglizhimi ndaj tyre është i papranueshëm.

Gjithashtu, është e rëndësishme të tregohemi të mençur duke mbrojtur veten tonë nga lëndimi ose akuzat e rreme ndaj shërbesës sonë dhe komunitetit ungjillor. Shpeshherë ne ekspozohemi ndaj mundësisë që çiltërsia dhe besimi ynë të shfrytëzohen dhe që vepërime të bëra me qëllim të mirë të keqkuptohen. Ne duhet të jemi në gjendje ta vërtetojmë qartë që kisha është një vend i sigurtë për të gjithë, gjë që bëhet me anë të vendosmërisë sonë për të treguar përkushtim ndaj mbrojtjes. (2 Korintasve 8:21)⁵

Le të sigurohemi që Politikat e Mbrojtjes të mësohen e të zbatohen në kishat tona, në mënyrë që askush të mos largohet nga Jezusi dhe që askush nën kujdesin tonë të mos lëndohet për shkak të mosangazhimit, padijes dhe neglizhencës tonë.

Pa një udhëheqje të urtë populli bie, por ka shpëtim në numrin e madh të këshilltarëve. (Fjalët e Urta 11:14).

⁵ 2 Korintasve 8:21: “...sepse kujdesemi të veprojmë mirë jo vetëm përpara Zotit, por edhe përpara njerëzve”.

1.3 MIRËNJOHJE

Ne falënderojmë dhe u jemi mirënjohës individëve të përmendur më poshtë, për kontributin dhe bashkëpunimin e tyre në zhvillimin e kësaj politike:

Pjesëmarrësit në tryezën e rrumbullakët për mbrojtjen:

Shënim: Renditja e emrave të mëposhtëm nuk është bërë për nga rëndësia, por nga mbledhja në tavolinë të rrumbullakët në mënyrë kronologjike.

Rachel Wilson (Themeluese dhe Drejtoreshë Ekzekutive, Fondacioni “Shkëndijë”)

Bonnie Stephen (Ish-infermiere, Fondacioni “Shkëndijë”)

Akil Pano (Ish-Sekretar i Përgjithshëm, VUSh)

Ada Ruçi (Punonjëse Sociale, Qendra “Rreze Dielli”)

Alma Vögeli (Psikologe, Fondacioni SFI)

Ruth Vergnon (Presidente, Fondacioni “Alo!Mik”)

Claudia Tahan (Punonjëse Sociale dhe Drejtoreshë e “Children & Families Together”)

Ridiona Stana (Ish-Menazhere e Programit të Mbrojtjes së Fëmijëve, “World Vision”)

Arvenola Bekteshi (Menazhere e Programit “Besim dhe Zhvillim”, “World Vision”);

Sue Davidson (Drejtoreshë Ekzekutive, “The Velemeta Trust”)

Ada Kita (Drejtoreshë Ekzekutive, “Qendra Xhonatan”)

Ergest Biti (Sekretar i Përgjithshëm, VUSh)

Sabina Tahsini (Koordinatorë për Mbrojtjen e Fëmijëve, “World Vision”);

Evis Stafa (Drejtoreshë Ekzekutive, “Global Care”)

Blerta Kamberi (Themeluese, Fondacioni “CHE AL”, Koordinatorë e Programit CSP);

Anila Aga (Trajnuese Fondacioni “CHE AL”)

Kontribues / Komentues:

Ina Verzivolli (Kryetare e Agjencisë Kombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, Ministria e Mirëqenies Sociale)

Ermal Nufi (Avokat, Këshilltar Ligjor)

Ylli Doçi (President, VUSh)

Elona Prroj (Drejtoreshë Ekzekutive, Fondacioni “Jo Gjakmarrjes! Po Jetës!”)

Fatjon Kadiu (Pastor, kisha “Lajmi i Mirë”, Fier)

Ali Kurti (Pastor, kisha “Burimi i Shpresës”, Peqin)

Meriton Cungu (Kisha Ungjillore “Ringjallja dhe Jeta”, Shkodër)

Aleksandër Molla (Koordinator “Aleanca e Veriut”, Këshilltar në VUSh, Pastor i kishës “Fjala e Jetës”, Laç);

Marinela Çomo (Drejtuese Fëmijësh, kisha “Nxënësit e Jezusit”)

Brunilda Rustani (Përkthyes)

Flora Pepmarku (Korrektore, Fondacioni “Shkëndijë”)

Falënderojmë pluspoint sh.p.k për faqosjen e këtij materiali.

Citimet biblike janë marrë nga Bibla, botimi 2009.

E drejta e autorit © SHOQËRIA BIBLIKE SHQIPTARE (A.B.S.) TIRANË

Përdorur me leje. Të gjitha të drejtat e rezervuara.



-2-

Politika e mbrojtjes

2. POLITIKA E MBROJTJES



Emri i kishës, organizatës, institucionit:

Adresa:

Emri i kontaktit:

Numri i kontaktit:

Email i kontaktit:

Emri i personit të caktuar për mbrojtjen:

Numri i kontaktit:

Email i kontaktit:

2.1 KUADRI LIGJOR

Kjo politikë mbështetet nga:

- Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës (1989);
- Ligji Nr. 10347 për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, i datës 04.11.2010;
- Udhëzim Nr. 10, datë 25.02.2015, për mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në rrezik, për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve;
- Standardet për Shërbimet Sociale në Shqipëri, tetor 2005.

Konventa e Kombeve të Bashkuara (OKB) për të Drejtat e Fëmijës përmban një seri standardesh minimale sipas të cilave duhet kryer kujdesi dhe mbrojtja e fëmijëve. Ajo është një marrëveshje detyruese ndërkombëtare të cilën qeveria shqiptare e ka firmosur në shkurt 1992.

Sipas Konventës së OKB-së, fëmijët kanë të drejtë për:

- Standard të pranueshëm jetese për të gjithë, përfshirë edhe ata me nevoja të veçanta;
- Mbrojtje nga dhuna, abuzimi dhe shfrytëzimi;
- Mbrojtje nga braktisja;
- Të përdorur gjuhën e tyre, për të shijuar kulturën e tyre e për të praktikuar fenë e tyre;
- Të qenë të lirë nga çdo formë diskriminimi me bazë racën, ngjyrën, gjininë, fenë, opinionin, kombësinë, orgjinën etnike ose sociale, statusin etj.

2.2 PËRKUFIZIME DHE LLOJET E ABUZIMIT

Sipas fushës së mbuluar nga kjo politikë, në të gjithë këto lloje abuzimesh përfshihen jo vetëm fëmijët, por edhe të rriturit e cenueshëm, sipas përkufizimeve të mëposhtme:

‘Fëmijë’ është çdo person i lindur gjallë, deri në moshën 18 vjeç.¹

‘Prind’ është personi/personat që e kanë lindur ose e kanë birësuar fëmijën të dy së bashku ose një i vetëm, të martuar ose të pamartuar apo që kanë njohur amësinë ose atësinë e fëmijës së lindur jashtë martesë.

‘Fëmijët pa kujdes prindëror’ janë ata fëmijë që nuk jetojnë me prindërit e tyre për arsye se:

- Të dy prindërit kanë vdekur;
- Gjykata e ka larguar fëmijën nga kujdestaria e prindërve;
- Fëmija ose fëmijët janë braktisur;
- Prindërit janë përkohësisht ose në mënyrë të përhershme të paaftë për t’u kujdesur për fëmijët e tyre (kur janë të sëmurë ose në burg).

‘Përfaqësues ligjor’ është kujdestari ose familja kujdestare, personi apo institucioni, i cili, brenda tagreve që i janë dhënë nga ligji ose nga gjykata, mbron interesat e fëmijës nëpërmjet kryerjes apo jo të veprimeve juridike, në emër ose për llogari të fëmijës

‘Kujdestar’ do të thotë çdo person të cilit i është besuar kujdesi për një fëmijë, qoftë në plan të përkohshëm ashtu edhe afatgjatë. Këtu përfshihen, ndër të tjera, mësuesit e Shkollës së të Dielës, pastorët, anëtarët e stafit të kishës ose vullnetarët, këshilltarët ose vullnetarët e kampeve, punonjësit e institucioneve, personat që punojnë me të rinjtë, dhe mentorët.

‘Fëmijë me nevoja të veçanta’ përkufizohet fëmija që, për shkak të një paaftësie mendore ose fizike, nuk ka arritur gurët kilometrikë normalë të zhvillimit. Për pasojë, ai/ajo ka nevojë për vëmendje të veçantë nga e gjithë shoqëria për t’u zhvilluar në maksimumin e kapacitetit të tij/saj.

‘I rritur i cenueshëm’ përkufizohet çdo person i moshës 18 vjeç e më shumë që ka ose mund të ketë nevojë për ndihmë për arsye të dëmtimit mendor, fizik ose të të nxënit; për arsye moshe ose sëmundjeje, që është ose mund të jetë i paaftë të kujdeset për veten ose i paaftë ta mbrojë veten nga dëmi domethënës ose shfrytëzimi serioz që mund të ndodhë nga veprimet ose mosveprimi i njerëzve të tjerë.

‘Konfidencialiteti’ do të thotë mbrojtje e identitetit dhe informacionit të fëmijëve duke mos ndarë informacion të ndjeshëm në lidhje me fëmijën ose familjen e tij/saj me persona që nuk kanë lidhje dhe nuk janë të autorizuar për të pasur këtë informacion.

‘Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës (NjMF)’ është njësia që funksionon brenda strukturës administrative të shërbimeve sociale të bashkisë. Ata janë përgjegjës për mbrojtjen dhe menazhimin e rasteve të fëmijëve në rrezik. Rasti i një fëmije në rrezik i referohet NjMF-së nga autoritetet përkatëse për vlerësim dhe mbrojtje.

‘Abuzim’ do të thotë një ose disa akte që e vënë fëmijën/të rriturin e cenueshëm në rrezik dëmtimi.

¹ Ligji Nr. 10347 me datë 4.11.2010: “Për Mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve” (pika d).

LLOJE TË ABUZIMIT:

Abuzimi fizik mund të përfshijë goditjen, shkundjen, hedhjen, helmimin, djegien ose përvëlmin, mbytjen, marrjen e frymës ose shkaktimin e llojeve të tjera të dëmit fizik ndaj fëmijës/të rriturit të cenueshëm. Në kontekstin shqiptar forma të tjera të abuzimit fizik mund të përfshihen shkulja e flokëve, tërheqja e veshit dhe pickimet.

Abuzimi emocional është keqtrajtimi i vazhdueshëm emocional i fëmijës/të rriturit të cenueshëm në mënyrë të tillë që të shkaktojë efekte të pafavorshme të rënda dhe të vazhdueshme në zhvillimin emocional të fëmijës. Këtu përfshihet edhe kur u thuhet fëmijëve se janë të pavlerë ose të padashur, të papërshtatshëm, ose të vlerësuar vetëm për aq kohë sa plotësojnë nevojat e një personi tjetër. Gjithashtu, këtu mund të përfshihet imponimi i pritshmërisë së papërshtatshme për moshën ose zhvillimin e fëmijëve. Mund të përfshihet edhe shkaktimi i ndjenjave të frikës ose rrezikut të fëmijët, si edhe diskriminimi, shfrytëzimi ose korruptimi i fëmijëve; denigrimi, talljet, kërcënimet dhe kanosjet, komentet racore apo seksuale.

Abuzimi seksual përfshin detyrimin ose nxitjen e fëmijës/të rriturit të cenuar ose të riut për të marrë pjesë në veprimtari seksuale, pavarësisht nëse fëmija është i vetëdijshëm ose jo për çfarë po ndodh. Në këto veprimtari mund të përfshihet kontakti fizik, përfshirë këtu aktet e penetrimit ose jo, të tilla si ledhatimi, shtrëngimi, puthja, përqafimi ose prekja e të miturve në mënyrë të papërshtatshme, të padëshiruar ose pa ndjeshmëri ndaj kulturës. Këtu mund të përfshihen edhe veprimtari pa kontakt, të tilla si përfshirja e fëmijëve në shikimin e materialeve pornografike ose të parët e veprimtarive seksuale, në prodhimin e materialeve pornografike, joshja dhe inkurajimi i fëmijëve për t'u sjellë në mënyra të papërshtatshme seksualisht, ose shfrytëzimi i fëmijëve për kënaqësi seksuale. Abuzimi seksual mund të përfshijë përfitimin financiar nëpërmjet shfrytëzimit përmes pornografisë, prostitucionit apo trafikimit të personave.

Neglizhimi është paaftësia e vazhdueshme për të plotësuar nevojat fizike dhe/ose psikologjike të fëmijës/të rriturit të cenueshëm, paaftësi që ka gjasa të rezultojë në dëmtim serioz të shëndetit ose zhvillimit të shëndetit të fëmijës. Këtu mund të përfshihet paaftësia e prindit ose kujdestarit për të siguruar ushqim, strehë dhe veshje të përshtatshme, paaftësia për ta mbrojtur fëmijën nga dëmtimi ose rreziku fizik, përfshirë këtu abuzimin, si edhe paaftësia për të siguruar kujdesin ose trajtimin e përshtatshëm mjekësor. Gjithashtu, këtu mund të përfshihet braktisja, mospërfillja ose mospërgjigja ndaj nevojave emocionale dhe edukimit bazë të fëmijës.

Abuzimi shpirtëror lidhet me abuzimin emocional. Abuzimi shpirtëror mund të përkuftizohet si abuzim i pushtetit, i bërë shpesh nën emrin e Perëndisë ose të fesë, ku përfshihet manipulimi ose imponimi i dikujt për të menduar, thënë ose bërë gjëra pa respektuar të drejtën e individit për të zgjedhur vetë për veten e tij/saj. Disa tregues të abuzimit shpirtëror mund të jenë: një udhëheqës që i frikëson të tjerët dhe imponon vullnetin e tij/saj mbi ta, ndoshta duke i kërcënuar me pasoja të tmerrshme ose me zemërimin e Perëndisë në rast mosbindjeje. Ai ose ajo mund të thotë se Perëndia i ka zbuluar gjëra të caktuara dhe se ai/ajo e di se çfarë është e drejtë. Njerëzit nën udhëheqjen e tyre kanë frikë të sfidojnë ose të kundërshtojnë, me besimin se do të humbasin pranimin dhe miratimin e udhëheqësit (ose, edhe më serioze, të Perëndisë).

'Bullizmi' është keqtrajtimi në përgjithësi i fëmijëve nga bashkëmoshatarët e vet, në formë të ndryshme abuzimi, ku mund të përfshihet ngacmimi, tallja, kërcënimet, komentet e papërshtatshme apo goditjet, etj.

Shfrytëzimi Sipas ligjit shqiptar, fëmijët kanë të drejtën të jenë të mbrojtur nga shfrytëzimi ekonomik dhe nga kryerja e çfarëdo lloji pune që:

- mund të jetë e rrezikshme;
- pengon arsimin e tij/saj;
- kërcënon shëndetin e tij/saj;
- është e dëmshme për zhvillimin fizik, mendor, shpirtëror, moral ose social të fëmijës;
- është punë e detyruar.

2.2.1 TREGUESIT E ABUZIMIT

Treguesit/faktorët që tregojnë se po ndodh abuzim i ndonjë lloji janë të shumtë. Disa prej këtyre faktorëve mund të mos jenë shqetësues nëse merren si të izoluar por, të bërë bashkë, mund të përbëjnë shkak serioz për shqetësim.

Identifikimi i abuzimit është shpeshherë i vështirë. Është e dobishme të merret parasysh:

- A ka ndonjë shenjë dëmtimi ose sëmundjeje të pashpjeguar?
- Vënia re e shpjegimeve të pakuptimta lidhur me situatën përkatëse.
- Çfarë thotë fëmija/i rrituri i cenueshëm në mënyrë spontane?
- Një ndryshim të papritur të sjelljes si edhe përqëndrimi emocional.

TREGUES TË ABUZIMIT FIZIK

Mavijosje:

- × Mavijosje në sy, gojë ose veshë
- × Mavijosje në kohë të ndryshme në të njëjtin vend
- × Mavijosje me shenjë (d.m.th. shenja këpuce, rripi, gishtërinjsh)
- × Mavijosje pa ndonjë shpjegim të dukshëm
- × Mavijosje e foshnjave që nuk ecin ende

Djegie, kafshime dhe shenja:

- × Shenja të dukshme dhëmbësh
- × Djegie ose përvëlime me shenja rrethuese të qarta
- × Djegie të vogla në shenjë rrethi (cigare)
- × Numër i madh shenjash të kohëve të ndryshme.
- × Shenja që tregojnë se fëmija/i rrituri i cenueshëm nuk ka marrë trajtim mjekësor
- × Shenja me forma të pazakonta.

Thyerje:

- × Thyerje të fëmijët nën 1 vjeç.
- × Thyerje të pretenduara që nuk janë vënë re.

TREGUESIT E ABUZIMIT EMOCIONAL

- ✗ Sjellje pasive, letargjike ose kërkimi i vëmendjes në mënyrë anormale.
- ✗ Çrregullime specifike të sjelljes p.sh., vështirësi në të ushqyerit, vështirësi në të fjetur, ndotje fekale, urinim në shtrat.
- ✗ Vonesë e rëndë në zhvillimin social dhe të folurit.
- ✗ Sjellje nervoze të tepruara, si lëkundje të pakontrolluara ose shpërthime të papritura.
- ✗ Vetëvlerësim i ulët.
- ✗ Ndryshime ose përkeqësim i humorit ose sjelljes, veçanërisht në rastet kur fëmija tërhiqet/bëhet i ngjitur/depresiv/agresiv ose ka ankth ekstrem.
- ✗ Nervozizëm, humbje e vigjilencës ose vigjilencë e tepruar.
- ✗ Fiksime ose fobi.
- ✗ Ulje të papritura të arritjeve ose mungesë përqendrimi.
- ✗ Marrëdhënie të papërshtatshme me bashkëmoshatarët dhe/ose të rriturit.
- ✗ Sjellje që kërkon vëmendje.
- ✗ Arratisje/vjedhje/gënjeshtër/agresivitet/hiperaktivitet.
- ✗ Tentativë për vetvrasje/depresion/ankth/stres i shtuar.

TREGUESIT E ABUZIMIT SEKSUAL:

- ✗ Fëmija kryen akte seksuale të papërshtatshme me fëmijë të tjerë, veten e vet (masturbim) dhe të tjerë.
- ✗ Interes i tepërt për çështjet seksuale, njohuri e detajuar e sjelljes seksuale të të rriturve, ose luajtja e lojërave seksuale të papërshtatshme për moshën.
- ✗ Veprimtari seksuale përmes fjalëve, lojës ose vizatimit.
- ✗ Fëmija komunikon në gjuhë dhe terma seksualë të papërshtatshëm për moshën dhe zhvillimin e tij/saj.
- ✗ Gjatë veprimtarive, fëmija fërkon ose kruan vazhdimisht organet gjenitale.
- ✗ Fëmija ankohet për dhimbje ose ka gjakderdhje të papritur në zonën gjenitale.
- ✗ Fëmija ankohet për dhimbje ose infeksione në gojë/fyt.
- ✗ Vështirësi në ecje ose në qëndrimin ndenjor.
- ✗ Funkionim i dobët i fshikëzës së urinës.
- ✗ Shtatëzënësi.
- ✗ Fëmija ka shenja të SST-ve (Sëmundjeve Seksualisht të Transmetueshme).

TREGUES TË NEGLIZHIMIT

Fëmijët/të rriturit e cenueshëm të cilët:

- ✗ Kequshqyerja dhe humbja në peshë.
- ✗ Ngrënia e një sasive të madhe ushqimi gjatë një vakti dhe tendenca për të fshehur një pjesë të ushqimit për më vonë.
- ✗ Lodhje e vazhdueshme, apati ose përgjumje.
- ✗ Pakujdesi e vazhdueshme higjienike.
- ✗ Janë të ekspozuar ndaj lëndimeve për shkak të mungesës së mbikëqyrjes.
- ✗ Janë të ekspozuar ndaj mjediseve të papërshtatshme, të pista dhe/ose të ftohta, të nxehta.
- ✗ Janë braktisur ose lënë në rrethana pa mbikëqyrjen e përshtatshme nga të rriturit.
- ✗ Kujdestarët e tyre i kanë neglizhuar që të marrin këshillën/trajtimin e përshtatshëm mjekësor.
- ✗ Çrregullime të vazhdueshme në frekuentimin e shkollës.

TREGUES TË PËRGJITHSHËM

- ✗ Paaftësi e përsëritur për të kontrolluar urinimin, ditën ose natën.
- ✗ Shqetësime në të fjetur dhe të ngrënë.
- ✗ Dhimbje të shpeshta barku.
- ✗ Tërheqje nga shoqëria, izolim.
- ✗ Nervozizëm dhe gjendje kotësie.
- ✗ Besim i ulët dhe fshehtësi.
- ✗ Arratisje.
- ✗ Vetëlëndim.
- ✗ Kriza hysterike, gjendje të fikti etj.
- ✗ Depresion.
- ✗ Vetëvlerësim i ulët.

Treguesit e përgjithshëm mund të shfaqen te çdo fëmijë i abuzuar, por janë veçanërisht të rëndësishëm në rastet e abuzimit emocional dhe seksual, raste në të cilat shenjat e jashtme mund të mos jenë të pranishme.

Megjithatë, kujdestarët nuk duhet të dalin me përfundime të vetat nëse shohin një ose më shumë nga shenjat e mësipërme, sepse shumë fëmijë mund të shfaqin secilën prej këtyre shenjave dhe kjo nuk do të thotë që fëmija është detyrimisht i abuzuar. Prandaj është e rëndësishme që kujdestarët të njohin treguesit e mësipërm dhe, kur vëzhgojnë se një fëmijë shfaq disa tregues, kujdestarët duhet ta diskutojnë këtë me mbikëqyrësin ose kolegun e tyre për të bërë vëzhgime të mëtejshme dhe për të përcaktuar se si ta trajtojnë abuzimin e mundshëm.

Gjatë kësaj kohe duhet të tregohet ndjeshmëri e madhe dhe kujdes me informacionin që kujdestari siguron vetë duke vëzhguar fëmijën ose që vetë fëmija i tregon atij/asaj në

lidhje me abuzimin. Është shumë e rëndësishme ruajtja e këtij informacioni dhe ndarja e tij vetëm me personat përgjegjës.

TREGUES TË ABUZIMIT TE NJË I RRRITUR I CENUESHËM

× Raportimi me shkrim, me gojë ose me gjuhën e shenjave i vetë të rriturit për abuzim.

Në rast raportimi joverbal:

- × Çdo shenjë lëndimi në kokë ose në pjesë të tjera të trupit.
- × Pamja e tyre fizike është e papastër, rrobat janë të pista, të papërshtatshme ose jo të masës së duhur.
- × Ndryshim në afrimitet, humor ose sjellje.
- × Frikësohet kur i afrohet dikush.
- × Ndalon së marri pjesë në aktivitete të zakonshme.
- × Ndryshim i shpeshtë i kujdestarëve.

2.2.2 PARANDALIMI

PËR FËMIJËT:

Parimi bazë i punës me fëmijët/të rriturit e cenueshëm është që interesi më i mirë i fëmijës të jetë qëllimi parësor. Kjo do të thotë se siguria dhe mirëqenia e fëmijës duhet të jenë në qendër të çdo vendimi që merret për një fëmijë/të rritur të cenueshëm. Nëse kjo është gjëja parësore që merret në konsideratë, atëherë do të rezultojë në uljen e mundësive që fëmija të vendoset në një mjedis të rrezikshëm ose të pashëndetshëm.

Kujdestari mund të marrë masat paraprake të mëposhtme për t'u siguruar që nuk po vë në rrezik veten ose fëmijën/të rriturin e cenueshëm.

Një udhëzues i shkurtër: (Shikoni kodin e detajuar të praktikës së mirë në seksionin 3)

1. Gjendja vetëm për vetëm me fëmijët. Kujdestarët nuk duhet ta vendosin veten në një pozitë prej së cilës mund të akuzohen për abuzim. MOS qëndroni vetëm për vetëm me një fëmijë.
2. Kontrolloni sigurinë e mjedisit para se të ekspozoni fëmijët ndaj tij. Shikoni për çfarëdolloj rreziku të mundshëm në ambiente të brendshme dhe të jashtme, rreziqe që mund ta lëndojnë fëmijën, të tilla si: tela elektrike, objekte të mprehta të dala, ujëra të thella, shkëmbinj, gropa, trafik rrugor, ose gjithçka tjetër që mund t'i shkaktojë lëndim fëmijës.
3. Përdorimi i ndëshkimit fizik është një formë e papranueshme disipline nga stafi dhe vullnetarët. Çdo kujdestar duhet të trajnohet për metoda alternative pozitive të disiplinimit dhe për kontrollimin e fëmijëve të padisiplinuar.
4. Prekja e përshtatshme. Kujdestari duhet të prekë e të përgjigjet në mënyrë të përshtatshme sipas përgjegjësive të tij/saj dhe sipas llojit të veprimtarisë, duke marrë parasysh llojin e punës/aktivitetit. Ka ndryshim midis një takimi fëmijësh/adoleshentësh për një orë dhe përkujdesjes ndaj një foshnjeje në qendër rezidenciale.

5. Të qenët të ndërgjegjshëm për zgjedhjen e fjalëve dhe sjelljeve nga ana e kujdestarit. Kujdestarët duhet të sigurohen që nuk po përdorin gjuhë tallëse ose poshtëruese dhe të jenë të ndërgjegjshëm për mënyrën se si reagon fëmija/i rrituri i cenueshëm ndaj fjalëve dhe veprimeve të tyre. Nëse duket se shkaktojnë fyerje ose lëndim, ndërpritini ato gjëra që po bëni ose thoni. Kurrë mos e bëni fëmijën/të rriturin e cenueshëm objekt shakaje ose ta prezantoni në mënyrë poshtëruese para të tjerëve.
6. Të qenët përgjegjës për të gjithë kohën që fëmija është vendosur nën përkujdesjen tuaj, duke qenë prezent e vigjilent edhe për veprimet që fëmijët mund të bëjnë ndërmjet tyre, e sidomos në kohën që shkojnë në tualet, apo në kohë pushimi.

PËR TË RRITURIT E CENUESHËM

Të rriturit e cenueshëm (shih përkufizimin më lart në fq.11) kanë të drejtën për mbrojtje nga abuzimi. Si kujdestarë të personave që na janë besuar, ne duhet të sigurohemi që po ndjekim të njëjtat politika, udhëzime dhe protokolle që paraqiten në këtë politikë, në mënyrë që të parandalojmë rastet e abuzimit dhe të sigurohemi që të gjithë të jenë të mbrojtur nga lëndimi.

TRAJTIMI NJERËZOR

Të rriturit e cenueshëm kanë të drejtën të trajtohen me dinjitet njerëzor. Kjo do të thotë se të rriturit e cenueshëm kanë të drejtën:

1. t'u flitet me të njëjtin respekt që iu ofrohet të rriturve të tjerë në moshë të ngjashme me të tyren;
2. të jenë të pastër dhe të veshur në mënyrë të përshtatshme;
3. të kenë ushqim, strehim dhe rehati;
4. të jenë të mbrojtur ndaj të gjitha llojeve të abuzimit të renditura më lart;
5. të jenë të mbrojtur ndaj vjedhjes dhe shfrytëzimit.

2.3 PERSONI I CAKTUAR PËR MBROJTJEN

<p>Emri i organizatës, kishës ose institucionit</p> <p>ia ka deleguar rolin e personit të caktuar për mbrojtjen e fëmijëve/të rriturve të cenueshëm nën kujdesin e:</p> <p>Emri</p>
--

Personi i caktuar për mbrojtjen duhet të ketë njohje të mirë të politikës së mbrojtjes dhe mënyrës se si ajo vihet në zbatim. Ai/ajo është përgjegjës t'ua komunikojë udhëzimet e paraqitura në politikë të gjithë anëtarëve të organizatës. Ai/ajo duhet të mbajë të dhëna të përditësuara, të marrë pjesë në trajnime, të kuptojë si trajtohen pretendimet dhe ankesat, dhe të dijë si t'iu përgjigjet zbulimeve të abuzimeve me korrektësi, në mënyrë të përshtatshme e me ndjeshmëri. Personi i caktuar për mbrojtjen është përgjegjës për

gjetjen e emrit dhe të numrit të Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijës (NjMF) në zonën e tyre, informacion ky që merret në këshillin vendor. Ata duhet të dinë si bëhen referimet dhe të sigurohen që të gjithë anëtarët e organizatës të jenë të trajnuar siç duhet për kryerjen e përgjegjësive të tyre.

2.3.1 RAPORTIMI I AKUZAVE PËR ABUZIM

(Shih edhe Udhëzimet 3.1)

RAPORTIME TË ABUZIMIT TË FËMIJËVE

1. Çdo person, përfshirë ai anonim, që ka motive të arsyeshme për të besuar se një fëmijë/i rritur i cenueshëm ka qenë subjekt i abuzimit ose akteve të abuzimit duhet t'ia raportojë menjëherë rastin personit përgjegjës, d.m.th., personit të caktuar për mbrojtjen/pastorit/drejtorit.
2. _____ kontakton me NjMF-në, me telefon ose mjete të tjera. Është detyra e NjMF-së të kryejë vlerësim të plotë, nëse e shohin të nevojshme. Në rast pamundësie kontakti me NjMF-në, duhet kontaktuar Policia. (Shih shtojcën për listën e numrave të këshillit vendor (Bashkisë) për rrethet e ndryshme të Shqipërisë dhe VKM nr. 265).
3. Nëse individi që paraqet shqetësimin mendon se personi i caktuar për mbrojtjen/pastori/drejtori nuk është përgjigjur në mënyrën e duhur, ai/ajo sigurisht gëzon të drejtën, si çdo individ, të referojë drejtpërdrejt te NjMF.
4. NjMF e nis procesin e vlerësimit duke vlerësuar nëse fëmija është në rrezik të lartë e nëse nevojitet ndërhyrje e menjëhershme.
5. Në rast emergjence, fëmija do të vihet nën kujdesin e Policisë në koordinim me NjMF-në dhe shërbimet sociale.
6. Nëse nuk është rast emergjent ose pas planit të parë të emergjencës, NjMF fton aktorët e ndryshëm (grupi multidisiplinar) në një diskutim për të vendosur mbi një plan veprimi.
7. Veprimet ndërmerren në bashkëpunim me aktorët e drejtpërdrejtë, dhe grupi multidisiplinar sigurohet për vijimësinë e planit të veprimit.
8. Nëse policia ose shërbimet sociale vendosin të mos kryejnë hetime, personi i caktuar për mbrojtjen/pastori/drejtori mund të organizojë vetë hetime të brendshme dhe të ndërmarrë veprimet e nevojshme për mbrojtjen e fëmijës/të rriturit të cenueshëm.
9. Është e detyrueshme që personat që bëjnë raportimin e abuzimit të bashkëpunojnë plotësisht me policinë dhe me përfaqësuesit e shërbimeve sociale, rajonale ose të bashkisë.

RAPORTIMET PËR ABUZIM TË TË RRI TURVE TË CENUESHËM

Nëse mësoni se dikush (një i rritur i cenueshëm) ka nevojë për ndihmë të menjëhershme, ju keni mundësinë t'u drejtoheni disa instancave.

Ju mund të kontaktoni me rajonin më të afërt të policisë në zonën ku banoni, njësinë e

qeverisjes vendore në zonën tuaj (bashkia, komuna), ose qendrën shëndetësore më të afërt me zonën ku banoni ose ku ndodheni. Në çdo bashki, ju mund të gjeni përfaqësuesin e shërbimeve sociale që shërben si koordinator kombëtar për dhunën në familje.²

Për më tepër, ndihmë për ju mund të jenë edhe disa organizata jofitimprurëse që jo vetëm ofrojnë këshillë, por edhe ia referojnë rastin tuaj autoriteteve për ndihmë të specializur dhe të efektshme. Të dhënat për kontaktet e tyre përfshihen gjithashtu në këtë manual (shih listën e organizatave që punojnë me viktimat e dhunës në familje tek Shtojcat 4.4)

KONFIDENCIALITETI NË HETIME

Dyshimet ose pretendimet për abuzim nuk duhen diskutuar me autorin e dyshuar apo me dikë tjetër përveç personave të autorizuar si më lart. Informacioni që ju keni duhet të ruhet me shumë kujdes dhe të komunikohet vetëm me autoritetet përkatëse. Ruajtja e konfidencialitetit në rastet e abuzimit është një parim themelor, prandaj duhet të tregohet shumë kujdes dhe urtësi në dhënien e informacionit, pasi mund të ndesheni me raste që, edhe pse niseni me qëllimin e mirë për të ndihmuar fëmijën, mund të kryeni shkelje ligjore.

2.3.2 VEPRIMI DISIPLINOR

_____ kërkon nga secili prej punonjësve, kujdestarëve, vullnetarëve t'iu përmbahen rregullave të caktuara të punës dhe standardeve të sjelljes. Nëse punonjësi nuk i zbaton këto rregulla dhe standarde, mbikëqyrësi do të ndërmarrë veprime korigjuese.

1. Veprimi korigjues në _____ është progresiv. Veprimi i ndërmarrë si përgjigje ndaj thyerjes së një rregulli ose shkeljes së standardeve ndjek në mënyrë tipike një model serioziteti në rritje derisa thyerja ose shkelja të korigjohet.
2. Në rendin e zakonshëm të veprimeve korigjuese përfshihen:
 - a. **Paralajmërimi/këshillimi verbal.**
 - b. **Paralajmërimi me shkrim**, për t'u vendosur në dosjen e personelit.
 - c. **Shërbimi i provës.** Një periudhë kohore e vendosur nga mbikëqyrësi e që i lejon punonjësit/vullnetarit të shfaqë përparim/përmirësim. Ndryshimi/mosndryshimi duhet të jetë i dokumentuar me shkrim sipas formularit të performancës në punë.³
 - d. **Pezullimi.** Largimi i menjëhershëm, i kufizuar në kohë dhe pa pagesë i punonjësit/vullnetarit nga ambienti i punës, siç përcaktohet e ndërthurur me këshillim me Drejtorin Ekzekutiv dhe/ose Bordin e Drejtuesve, i shpallur gojarisht dhe i ndjekur nga njoftimi me shkrim, i vendosur në dosjen personale të punonjësit/vullnetarit.
 - e. **Ndërprerja** e detyrave si punonjës/vullnetar.

Duhet vënë re se disa rrethana të pazakonta e përligjin ndërprerjen e menjëhershme të marrëdhënieve të punës.

² Ligji nr.9669, datë 18.12.2006: "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare".

³ Formulari i Performancës në Punë zhvillohet nga punëdhënësi (autoriteti përgjegjës në Kishë/Organizatë) në zbatim të dispozitave të Kodit të Punës, Ligji Nr. 136 (I ndryshuar në 2015)

Më poshtë jepen shkaqet e drejta për **ndërprerjen e menjëhershme** të marrëdhënieve të punës me punonjësit, por pa u kufizuar vetëm në to:

- Abuzimi (siç përkufizohet në këtë politikë)
- Paaftësia për të raportuar te mbikëqyrësit/autoritetet (shih nivelet në seksionin 3.1 për procedurat e mira).
- Akuzat për abuzim ose dyshimet për abuzim.
- Shkelja e konfidencialitetit në lidhje me fëmijën/të rriturin e cenueshëm/punonjësin/anëtarin, dhe të gjithë çështjeve të brendshme, dosje që mbahen në mirëbesim dhe besueshmëri të lartë.
- Përdorimi i përsëritur i gjuhës së papërshtatshme dhe abuzive.
- Sulmi ose kërcënimi për lëndim fizik.
- Diskriminimi, ngacmimi seksual ose shkelje të tjera civile ose penale.

PUNONJËSI/VULLNETARI

Unë kam lexuar dhe pranoj t'u përmbahem të gjitha parimeve të kësaj politike siç shënohet më lart, si dhe kam lexuar dhe do t'i zbatoj në praktikë udhëzimet për mbrojtjen e personave nën kujdesin tim.

Emri:

Shëno emrin dhe firmos

Personi i caktuar:

Shëno emrin dhe firmos

Data:

Data:

2.4 KODI I SJELLJES PËR ÇDO STAF/VULLNETAR

_____ e merr seriozisht mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijëve. Të gjithë personat që punojnë me _____ në çfarëdo përgjegjësie dhe pavarësisht nëse paguhen ose jo, janë të detyruar të zbatojnë kushtet e Politikës së Mbrojtjes.

Duke firmosur këtë formular, ju bini dakord të punoni brenda kushteve të kësaj politike dhe udhëzimeve vijuese për sjelljen.

Unë _____ bie dakord që:

Jam i detyruar të zbatoj kushtet e Politikës së Mbrojtjes, dhe që më është dhënë një kopje e këtij dokumenti për të cilin kam marrë shpjegim.

Në mënyrë specifike, për të garantuar sigurinë e fëmijëve dhe të të rinjve,

UNË DO TË

- marr pjesë në trajnime që më ofrohen në lidhje me mbrojtjen dhe ruajtjen e fëmijëve;
- trajtoj të gjithë fëmijët dhe të rinjtë me barazi dhe respekt, dinjitet dhe ndjeshmëri, në sjellje, gjuhë dhe veprime;
- veproj sipas standardeve më të larta të sjelljes profesionale, përfshirë mënyrën se si silllem dhe si u përgjigjem partnerëve dhe pjesëtarëve të komunitetit;
- zbatoj, për sa është e mundur në rolin tim, parimin e “interetit më të lartë të fëmijës”, duke marrë parasysh nevojat dhe mirëqenien e fëmijës para se të merret një vendim që prek atë;
- sigurohem që të marr autorizim nga prindërit/kujdestarët dhe të kërkoj përfshirjen maksimale të tyre;
- garantoj sigurinë duke qenë i/e përgatitur e duke vlerësuar mjediset fizike ku do të jenë të pranishëm fëmijët;
- punoj në një mjedis të hapur duke shmangur situatat private ose pa vëzhgim kurdoherë që është e mundur;
- mbaj kufij fizikë të sigurtë e të përshtatshëm me fëmijët (për shembull, duke mos dhënë kujdes personal për gjëra që fëmijët mund t'i bëjnë vetë);
- kërkoj të përdor metoda alternative pozitive për disiplinimin dhe kontrollin e fëmijëve të padisiplinuar;
- raportoj çdo shqetësim, sado i paqartë të jetë, në lidhje me mirëqenien e fëmijëve ose sjelljen e një të rrituri, duke e sjellë në vëmendjen e _____ dhe,
- kërkoj drejtim e mbështetje nga _____ sa herë që nuk jam i/e sigurtë për rolin dhe përgjegjësitë e mia ose për mënyrën më të mirë të veprimit.

Në mënyrë specifike,

UNË KURRË NUK DO TË:

- qëndroj vetëm me një fëmijë, jashtë shikimit të të tjerëve;
- përfshihem në lojëra të dhunshme, në lojëra që janë fizikisht ose seksualisht provokuese dhe të bërit e komenteve me nënkuptime seksuale ndaj/përpara një fëmije (as për shaka);

- lejoj ose përfshihem në asnjë formë prekjeje/përçafimi të papërshtatshëm të fëmijëve;
- përdor gjuhë të papërshtatshme përpara fëmijëve, as t'i lejoj fëmijët të përdorin gjuhë të papërshtatshme me të tjerët;
- bëj fëmijët objekt shakaje ose t'i paraqes në mënyrë poshtëruese para të tjerëve;
- përdor ndëshkim trupor/fizik të asnjë lloji, as ndonjë lloj disiplinimi psikologjik ose emocional;
- lejoj që deklaratat e bëra nga fëmijët të mbeten të pavëna në dyshim, të padokumentuara ose pa reagim;
- shfaq preferenca ndaj një fëmije/grupi fëmijësh, as të ndërtoj marrëdhënie preferenciale me këtë/këta fëmijë jashtë hapësirës së punës (vëzhgim: nëse unë e ka njohur fëmijën që më parë, atëherë këtë rast do ta diskutoj paraprakisht me _____ ;
- shpërndaj dhurata, ëmbëlsira ose para, pa e diskutuar paraprakisht me _____.
- jap mjekim pa qenë i/e trajnuar dhe i/e autorizuar në mënyrë specifike për këtë.
- bëj fotografi ku fëmijët duken të veshur në mënyrë minimale ose aspak, ose që mund të konsiderohen poshtëruese;
- përdor pamje të fëmijëve ose informacion nga intervistat për asnjë qëllim tjetër (media sociale etj.) përtej atyre të lejuara paraprakisht nga _____ dhe të miratuara nga fëmijët dhe prindërit/kujdestarët e tyre;
- bëj pyetje të bezdisshme e private në lidhje me çështje të ndjeshme, përveçse nëse janë diskutuar paraprakisht, në mënyrë që të jetë vendosur mbështetja e përshtatshme;

Unë e kuptoj se çdo sjellje diskriminuese, fyese, e dhunshme ose jashtë Politikës së Mbrojtjes, është e papranueshme dhe se zbulimi dhe raportimi i saj do të rezultojë në marrjen e masave. Këtu mund të përfshihet pezullimi nga puna dhe/ose përfshirja në aktivitetet e _____ dhe/ose masa penale.

Gjithashtu, unë _____ deklaroj se:

- Nuk jam dënuar kurrë për sjellje të papërshtatshme me fëmijët dhe nuk kam precedentë penalë, gjë që mund ta vërtetoj me anë të dëshmisë së penaltetit.
- Jam plotësisht i/e ndërgjegjshëm për rëndësinë e mosfshesjes së informacionit mbi çfarëdo lloj abuzimi që fëmijët të cilët kanë qenë nën përgjegjësinë time kanë vuajtur ose po vuajnë. Unë e di edhe se personi tek i cili duhet të raportoj çdo dyshim, në fillim në mënyrë verbale e më pas duke përdorur formularin e referimit, është _____
- Bie dakord se është përgjegjësia ime të ruaj në mirëbesim çdo informacion që ka të bëjë me një dyshim ose abuzim real të një fëmije, përveçse nëse informacioni është i kufizuar për personat që duhet ta ofrojnë atë në përputhje me kërkesat e procedurës.

Firma: _____

Data: _____



-3-

**Udhëzimet
dhe procedurat**

3. UDHËZIMET DHE PROCEDURAT



3.1 UDHËZIMET DHE PROCEDURAT STANDARDE

DYSHIMI PËR ABUZIM

Marrja e deklaratave nga një fëmijë

- Qëndroni të qetë dhe dëgjoni me kujdes çfarë thuhet, mos reagoni në mënyrë të tepruar, mos kritikoni e mos u tregoni gjykues ndaj asaj që thotë fëmija.
- Mos premtoni mbajtje sekretesh – shpjegoni se informacione të tilla janë të nevojshme të ndahen, dhe sigurojeni fëmijën se ka bërë gjënë e duhur.
- Lejojeni fëmijën të vazhdojë të flasë/tregojë në ritmin e vet.
- Bëni pyetje vetëm për qartësi dhe shmangni çdo pyetje që mund të sugjerojë një përgjigje të caktuar.
- Tregojini fëmijës (duke konsideruar gjithmonë moshën e tij) çfarë do të bëni në vijim dhe me kë do ta ndani informacionin, duke i shpjeguar rolin e tij si dhe çfarë mund të bëjë. Incidenti nuk duhet të diskutohet me askënd tjetër që nuk ka lidhje me rastin.
- Siguria e fëmijës është kryesore. Nëse fëmija ka nevojë për vëmendje urgjente mjekësore telefono urgjencën mjekësore, informoni mjekët për shqetësimin dhe sigurohuni se ata janë bërë të vetëdijshëm se kjo është një çështje për mbrojtjen e fëmijës;
- Regjistroni me shkrim fjalët e thëna sa më shpejt të jetë e mundur, duke përdorur fjalët e fëmijës, nëse është e mundur. Mbani shënim kohën, datën dhe emrat e ndryshëm që përmenden. Firmoseni dokumentin dhe shënoni në të datën. Njoftoni personin e caktuar, i cili menjëherë pas kësaj plotëson dhe firmos një Raport të Abuzimit të Fëmijës dhe ia jep për ta firmosur edhe personit që ka informacionin e dorës së parë.

Procedura e trajtimit të dyshimit për abuzim referuar nga një punonjës.

1. Në rast se një punonjës/vullnetar dyshon ose vë re se një fëmijë ka shenja abuzimi ai/ajo duhet të komunikojë me personin përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve brenda kishës/organizatës.
2. Së bashku plotësojnë formularin e pretendimit (shiko shtojca 5.1).
3. Personi përgjegjës e trajton rastin sipas procedurave të brendshme të kishës/organizatës, dhe, nëse është e nevojshme, i drejtohet institucioneve përgjegjëse sipas ligjit.

RAPORTIMI I ABUZIMIT PRANË AUTORITETEVE

Bazuar në Ligjin Nr. 10347 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”, përgjegjësia parësore për mbrojtjen e fëmijëve është e Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijës (NjMF), e cila duhet të gjendet pranë çdo bashkie/komune (njësie administrative). Sipas ligjit, të gjithë aktorët dhe palët e interesuara kanë detyrimin ligjor të mbrojnë fëmijët dhe, në përgjithësi, të mbështesin punën e NjMF-së. Rrjedhimisht të gjitha strukturat, institucionet publike dhe jo-publike duhet t’u përgjigjen situatave abuzive, qofshin këto ekzistuese ose të dyshuara. Në praktikë, kjo do të thotë se të gjithë aktorët duhet:

1. T’i referojnë NjMF-së rastet kur ka shqetësim për sigurinë e një fëmije.
2. Të mbështesin NjMF-në në mbrojtjen e fëmijëve përmes ofrimit të shërbimeve.
3. Të mbështesin NjMF-në duke marrë pjesë në takime për të rishikuar rastet e duke planifikuar ndërhyrje.

Si duhet të raportoj tek autoritetet?

Hapi i parë në procesin e menazhimit të rastit është identifikimi i tij, gjë që mund të vijë si rezultat i një incidenti ose për shkak të rritjes së shqetësimit në lidhje me mirëqenien e fëmijës.

Institucionet dhe/ose ofruesit e shërbimeve që identifikojnë rastin duhet t’ia referojnë atë NjMF-së, duke plotësuar formularin e përshtatshëm (*shih formular në shtojcën 5.3). Referimet në NjMF duhen bërë brenda 24 orësh nga identifikimi i rastit, ose ditën vijuese të punës.

Në rastin kur fëmija është në rrezik të drejtpërdrejtë (situatë emergjente), policia duhet të kontaktohet e para dhe pak më pas NjMF ose strukturat e Shërbimit Social Shtetëror, në mënyrë që të garantohet siguria e fëmijës duke e vënë atë nën mbrojtje të menjëhershme.

Çfarë do të ndodhë më pas?

Fazat e menazhimit të rastit:

1. Identifikimi i çështjes ose referimi i një fëmije te njësia për mbrojtjen e fëmijës. Në këtë hap plotësohet një formular referimi/identifikimi për rastin e fëmijës.
2. Vlerësimi fillestar i situatës së fëmijës për të matur rrezikun e mundshëm që kanos fëmijën. Në këtë hap merret një vendim për veprimin që duhet ndër marrë menjëherë.
3. Më pas bëhet një vlerësim tërësor i situatës së fëmijës.
4. Takimi për mbrojtjen e fëmijës – një takim me grupin multidisiplinar i mbajtur për zhvillimin dhe rënien dakord për planin individual të mbrojtjes së fëmijës.
5. Vënia në zbatim e planit dhe ndërhyrja nga punonjësi i njesisë për mbrojtjen e fëmijës dhe aktorë të tjerë në përputhje me planin individual për mbrojtjen e fëmijës.
6. Takimi rishikues për mbrojtjen e fëmijës bëhet të paktën një herë në tre muaj, për të vlerësuar përparimin me planin dhe për të marrë një vendim nëse fëmija është ende në rrezik e se çfarë veprimesh të tjera është e nevojshme të ndërmerren.
7. Mbyllja e dosjes së fëmijës pasi fëmija të mos jetë më në rrezik, lëndim ose abuzim.

Cili është roli i kishës/organizatës?

- Çdo person që dyshon se një fëmijë është abuzuar dhe ka nevojë për mbrojtje duhet t'ia referojë rastin personit përgjegjës të kishës/organizatës dhe ai/ajo e referon më tej tek NjMF-së. Këshillohet që çdo strukturë ose institucion të identifikojë paraprakisht Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijës dhe të ketë gati numrat e telefonit për të lehtësuar raportimin.
- Personi që bën raportin inkurajohet të marrë pjesë në takimet e grupit teknik multidisiplinar për të ndihmuar në zhvillimin dhe vënien në zbatim të planeve individuale të kujdesit që zhvillohen për fëmijën.
- Kisha ose organizata duhet të planifikojë ndihmën në ofrimin e shërbimeve për fëmijët dhe familjet në përputhje me planin individual që zhvillohet nga skuadra multidisciplinare.
- Rekomandohet që kisha/organizata të mbajë kontakte të rregullta me NjMF-në në lidhje me vënien në zbatim të planit, si dhe për çdo situatë problematike.
- Kisha/organizata mund të ofrojë ndihmë në lehtësimin e kontakteve ndërmjet fëmijës dhe familjes.

REKRUTIMI I STAFIT DHE VULLNETARËVE

*shih formularin e aplikimit në shtojcën 5.5

Rekrutimi i kujdesshëm dhe i ndjeshëm është me rëndësi madhore kur bëhet fjalë për fëmijët/të rriturit e cenueshëm. Siguria e fëmijëve/të rriturve të cenueshëm është shqetësimi ynë kryesor. Më poshtë jepen disa hapa që sugjerohen të ndërmerren për të mbrojtur fëmijët/të rriturit e cenueshëm nën kujdesin tonë.

1. Është e dobishme të keni një person në kishën/organizatën tuaj që të jetë përgjegjës për rekrutimin e punonjësve/vullnetarëve.
2. Rekomandohet brenda mundësive të pranohen persona që janë tashmë anëtarë të njohur të një kisha. Të ardhurit e rinj në kishë përgjithësisht duhet të inkurajohen të mirëvendosen në jetën e kishës para se të marrin përsipër çfarëdo përgjegjësie mbi fëmijët/të rriturit e cenueshëm.
3. Kërkojini punonjësit të mundshëm të plotësojnë një formular aplikimi dhe një formular vetëdeklarimi (edhe nëse ka qenë anëtar i kishës për një kohë të gjatë). Është shumë e rëndësishme t'i mbrojmë fëmijët në kujdesin tonë dhe të ndjekim procedurat më të mira praktike që mundemi. Duke konsideruar që secili person është përgjegjës përpara ligjit për punën që bën me fëmijët.
4. Merrni referenca sipas formularëve të aplikimit, dëshminë e tyre të penalitetit dhe/ose certifikatën e dëshmisë së penalitetit, si dhe raportin e aftësisë për punë. Ky informacion duhet të ruhet në një vend të sigurtë.

Stafet/vullnetarët e huaj duhet të dorëzojnë dokumente të barasvlershme nga vendlindja e tyre, para ardhjes së tyre, pra dëshminë e tyre të penalitetit (certifikata e dëshmisë së penalitetit) dhe dokumente të tjera të kërkuara nga ligji, si p.sh., raportin e aftësisë për punë. Gjithashtu, këshillohet që drejtuesi i kishës së tyre të dërgojë një letër rekomandimi.

5. Është e rëndësishme të bëhet një intervistë e stafit/vullnetarëve të mundshëm për të kuptuar pse dëshirojnë të përfshihen në punën me fëmijët.
6. Si rregull i përgjithshëm, lejoni që punonjësi i mundshëm të vëzhgojë një takim fëmijësh dhe praktikisht të kuptojë nëse mund të punojë me fëmijë ose jo.
7. Sipas ligjit nr.142 të Kodit të Punës, çdo pjesëtar i stafit duhet të ketë një kontratë të rregullt pune. Për çdo punonjës të ri vendoset një periudhë prove (zakonisht tre muaj). Ligji kërkon që edhe për vullnetarët të ketë një marrëveshje me shkrim, ku të përshkruhen përgjegjësitë dhe e roli i tyre në punën me fëmijët/të rriturit e cenusëshëm.

MBIKËQYRJA DHE RAPORTET E STAFIT

Fëmijët duhen mbikëqyrur në çdo kohë dhe është detyra e drejtuesit të skuadrës të sigurohet që kjo të jetë e mundur. Raporti i përshtatshëm staf-fëmijë është një mënyrë e efektshme për të minimizuar çdo mundësi që fëmija të lëndohet ose që të ngrihen dyshime kundër një punonjësi. Në përgjithësi, këto janë raportet e sugjeruara për të siguruar mbikëqyrjen e duhur:

Raportet standarde të rekomanduara janë:

0-2 vjeç	1 punonjës për 3 fëmijë
2-3 vjeç	1 punonjës për 4 fëmijë
3-7 vjeç	1 punonjës për 8 fëmijë

8 vjeç e më shumë 2 punonjës (preferohet një për çdo gjini) për deri në 20 fëmijë

Duhet të ketë një punonjës shtesë për çdo 10 fëmijë dhe/ose të rinj shtesë. Mbani mend se do t'ju nevojiten më shumë punonjës nëse keni fëmijë me nevoja të veçanta.

Gjëra që duhet të merren parasysh në vlerësimin e raporteve të stafit, duke iu referuar edhe vlerësimin të rrezikut:

- Shqyrtoni planimetrinë e ambientit tuaj, d.m.th. pozicionin e dymëve, numrin e tyre etj., në varësi të të cilave mund t'ju nevojiten punonjës shtesë.
- Aftësitë e punonjësve tuaj – A janë të trajnuar për të përballuar një rast emergjence?
- Nivelin e eksperiencës dhe përgjegjshmërisë së tyre.
- Nivelet e mbikëqyrjes duhet të jenë më të mëdha gjatë udhëtimeve dhe vizitave. Për shembull, në rastin e një aktiviteti për të notuar (në një vend publik me roje plazhi), raporti i stafit për fëmijët nën 8 vjeç duhet të jetë një i rritur për çdo fëmijë.

UDHËZIME TË PËRGJITHSHME PËR SJELLJEN E STAFIT/VULLNETARËVE

Të përgjithshme

- Të siguroheni që çdokush trajtohet me dinjitet dhe respekt në sjellje, gjuhë dhe veprim.
- Stafit/Vullnetarët nuk duhet të qëndrojnë kurrë vetëm për vetëm me një fëmijë. Gjithmonë qëndroni ku të tjerët mund t'ju shohin.

Disiplina

Kur i referohemi disiplinës, fëmijët duhet të kuptojnë se çfarë pritet prej tyre në lidhje me atë që konsiderohet sjellje e përshtatshme dhe e papërshtatshme. Për ta arritur këtë, pritsshmëria, rregullat dhe rregulloret duhet të vendosen në vende ku mund të shihen lehtësisht, si dhe të kuptohen qartë nga fëmijët dhe stafi. Më poshtë jepen disa udhëzime për disiplinën:

- Drejtuesit e organizatës duhet të vendosin që më parë për mënyrat e disiplinimit dhe pasojat për sjelljen e papërshtatshme. Gjithashtu, fëmijët dhe prindërit e tyre duhet t'i kuptojnë e të bien dakord me pasojat/disiplinën që më parë.
- Disiplina duhet të marrë parasysh moshën e fëmijëve dhe seriozitetin e veprimeve të tyre.
- Disiplina nuk duhet të jetë kurrë poshtëruese. Përpiquuni të përdorni disiplinën pozitive dhe jo atë negative.
- Ndalohet çdo formë dhune dhe ndëshkimi ndaj fëmijës, qoftë fizike, psikologjike ose emocionale.

Prekja e papërshtatshme

- Një përqafim në kontekst grupi është shumë ndryshe nga një përqafim në ambient me dyer të mbyllura.
- Prekja duhet të jetë e lidhur me nevojat e fëmijës/të rriturit të cenueshëm dhe jo të punonjësit. Të gjithë fëmijët, të rinjtë dhe të rriturit e cenueshëm kanë të drejtën për privatësi, si dhe të drejtën për të vendosur sa kontakt fizik të kenë me të tjerët, përveç rrethanave të tilla si emergjencat mjekësore.
- Prekja duhet të jetë në përshtatje me moshën dhe normat e vendit dhe, përgjithësisht, nisma për të i takon fëmijës, të riut ose të rriturit të cenueshëm më tepër sesa punonjësit.
- Shmangni çdo veprimtari fizike që mund të jetë seksualisht stimuluese.

VLERËSIMI I RREZIKUT

Të qenët të përgatitur dhe vlerësimi i ambienteve fizike përreth dhe i veprimtarive janë aspekte të rëndësishme të garantimit të sigurisë.

Para çdo veprimtarie, vlerësoni zonën përreth dhe merrni masa paraprake. Përgjigjuni këtyre pyetjeve:

- A ka ndonjë rrezik në mjediset e brendshme/jashtme, si për shembull objekte të mprehta/të dala në mure/dysheme, tela të zhveshura ose pengesa që mund të shkaktojnë lëndim?
- A janë të sigurta karriget dhe tryezat?
- A është e ndriçuar mirë zona, apo ka pjesë të fshehta/të veçuara?
- A janë të sigurta hyrjet/daljet, në mënyrë që fëmijët të mos hyjnë në zona të rrezikshme si rrugët, ambiente me ujë etj.?
- A duhen kapërcyer rrugë kryesore/trafik makinash?
- A janë vendosur sendet djegëse si çakmakë/shkrepëse në vende të sigurta larg fëmijëve? A ka ndonjë rrezik zjarri?

- A janë vendosur lëndët helmuese si detergjentë, kimikate, medikamente, në vende të kyçura?
- A ka një kuti të ndihmës së shpejtë dhe fikëse zjarri gati për përdorim?
- A është i trajnuar stafi për të përdorur mjetet e sipërpërmendura të ndihmës së shpejtë?

Gjithashtu, vlerësoni edhe aktivitetet dhe merrni masa paraprake. Përgjigjuni këtyre pyetjeve:

- A është i sigurtë aktiviteti? Çfarë shkaqesh mund të çojnë në lëndim? Për shembull, gërsërët për punë dore ose rruaza të vogla.
- Aktivitetet me rrezikshmëri të lartë si gjuajtja me hark, ngjitja e shkëmbinjve dhe noti kërkojnë masa paraprake shtesë.
- A keni vendosur rregulla të qarta për lojën/aktivitetin në mënyrë që të parandaloni lëndimin? A është stafi juaj në dijeni të tyre?
- A janë të sigurta të gjitha materialet/pajisjet?
- A është i mjaftueshëm numri i stafit duke marrë në konsideratë moshat e fëmijëve dhe fëmijët me nevoja të veçanta? Shih pjesën për mbikëqyrjen dhe raportet e stafit.

(Mbani parasysh se njerëzit mund të mbajnë me vete mjete të rrezikshme si: armë, thika, grushte hekuri, lëndë narkotike etj.)

MEDIA

Në çdo formë komunikimi, fëmijët duhet të trajtohen dhe prezantohen me dinjitet dhe jo si viktime të pashpresa apo në poza me nënkuptime seksuale.

Bërja e fotografive/regjistrimi i imazheve

Shpesh ka paqartësi në lidhje me përshtatshmërinë e bërjes së fotografive të fëmijëve gjatë takimeve, festave, kampeve etj. Përgjithësisht, bërja e fotografive të fëmijëve tekta përfshihen pozitivisht në veprimtari normale është e pranueshme. Më e mira është që:

- të përqendrohemi në një veprimtari dhe, kur është e mundur, të shfaqim grupe fëmijësh e jo individë;
- të sigurohemi që fotografi/kameramani të mos kalojë kohë vetëm për vetëm me një fëmijë pa mbikëqyrje nga nje person i autorizuar ose pergjegjës;
- të kufizojmë bërjen e fotografive/filmimin vetëm nga një person i caktuar për këtë nga drejtuesi i veprimtarisë;
- fëmijët duhet të jenë gjithmonë të veshur në mënyrë të përshtatshme në fotografi të tilla, d.m.th., jo me rroba banje.

Çdo ankesë për imazhe të papërshtatshme duhet të raportohet e të regjistrohet si çdo shqetësim tjetër i mbrojtjes.

Publikimi i imazheve, interneti dhe rrjetet sociale

Teknologjia e ka lehtësuar përdorimin e fotografive dhe imazheve, si të shtypura në letër, ashtu edhe për faqe interneti. Rritja e përdorimit do të thotë përgjegjësi më e madhe për të siguruar mbrojtjen e të drejtave dhe sigurisë së personave të përfshirë në imazhe.

Më poshtë jepen disa hapa që mund të ndërmerren për të parandaluar cenimin e fëmijëve përmes komunikimeve, medias sociale dhe teknologjisë digjitale:

- Para përdorimit të imazhit, në çdo rast duhet të kërkohet leja me shkrim nga prindi/kujdestari dhe nga i rrituri i cenueshëm ose kujdestari i tij.
- Materialet e vendosura në mediat sociale ose teknologjinë digjitale nuk duhet të përmbajnë kurrë detaje identifikuese si emri, mbiemri ose vendndodhja/adresa personale e një fëmije.
- Materialet që përmbajnë informacione të fëmijës nuk duhet të kenë të dhëna të vendndodhjes gjeografike të saktë të tij/saj, nëse ai material përmban ndonjë të dhënë personale të fëmijës.
- Sa herë që është e mundur, duhen marrë masa paraprake për të parandaluar kopjimin elektronik të fotografive (duke vendosur një shenjë digjitale mbi fotografitë dhe funksionet e çaktivizimit të ruajtjes së imazhit/fotos me anë të klikimit të butonit të djathtë të mausit). Imazhet që janë të shoqëruara me të dhëna personale duhet të errësohen/turbullohen apo të mos transmetohen.

Fëmijët dhe të rriturit përballen me dy botë të ndryshme: me atë reale dhe atë virtuale. Ndërsa përpiqemi të mbrojmë fëmijën nga rreziqet fizike, duhet të mos lemë pas dore mbrojtjen nga rreziqet që u kanosen nga bota virtuale (interneti, rrjetet sociale, lojëra virtuale etj.) Në rrjetet sociale fëmija mund të komunikojë me shumë njerëz, por ndryshe nga lundrimi i thjeshtë në internet, fëmija mund të kontaktohet gjithashtu nga njerëz të tjerë, qofshin ata pozitivë apo negativë. Pikërisht këtu lind dhe nevoja për të mbrojtur fëmijën nga abuzime të mundshme. Është e rëndësishme t'i shpjegojmë fëmijës, madje ta kemi edhe vetë parasysh, që publikimi i fotove në rrjetet sociale mund të sjellë rrezikun e keqpërdorimit të tyre dhe abuzimit të forma të ndryshme (shantazhim, kërcënim, abuzime të ndryshme emocionale dhe seksuale etj.). Pavarësisht se fëmijët janë të aftë për të menazhuar teknologjinë digjitale ndonjëherë edhe më mirë sesa të rriturit, ata nuk janë mjaft të pjekur për të menazhuar rreziqet që mund të sjellë përdorimi i kësaj teknologjie. Ashtu siç mësojmë fëmijën të kalojë i sigurt në rrugën me trafik, ashtu duhet ta mësojmë të lundrojë i sigurt dhe i mbrojtur në internet.

REGJISTRI DHE MIRATIMI NGA PRINDI/KUJDESTARI

*shih modelin e formularit në shtojcën 5.2.

Miratimi nga prindi/kujdestari

Për çdo aktivitet, gjatë të cilit fëmijët janë nën kujdesin dhe mbikëqyrjen e një kishe/organizate (p.sh., ekskursione, kampe, takime javore etj.), prindërit duhet të plotësojnë një formular miratimi ku të përfshihen pikat e mëposhtme:

- Informacionet e kontaktit – emri, mbiemri i prindërve dhe numrat e telefonit.
- Një tjetër emër kontakti dhe numër telefoni, për rastet kur nuk mund të kontaktohen prindërit.
- Çdo informacion mjekësor/shëndetësor që duhet të dijë stafi, të tilla si alergjitë, kufizimet në dietë dhe mjekimet që merr fëmija.

Gjithashtu, stafi duhet t'u japë prindërve informacion se ku zhvillohet aktiviteti, numrin e telefonit të personit nga stafi që do të mbikëqyrë fëmijën e tyre, si dhe emrin e numrin e telefonit të një pjesëtari tjetër të stafit.

Regjistri

Për çdo aktivitet rekomandohet që të mbahet një regjistër, ku të shënohen emrat e pjesëmarrësve dhe data. Ky regjistër plotësohet nga stafi/vullnetarët që zhvillojnë këtë aktivitet.

REGJISTRIMI I INCIDENTEVE/AKSIDENTEVE

* Shih shembullin e një formulari në shtojcën 5.1.

Kishë/organizata duhet të ketë një regjistër, në të cilin shënohen të dhëna për incidentet/aksidentet që mund të ndodhin gjatë aktiviteteve me fëmijët/të rriturit e cenusshëm. Në regjistër shënohen të dhëna si: prerja, mavijosja, një aksident i ndodhur në tualet, shkallë etj. Për rastet si më sipër lajmërohen prindërit/kujdestarët

NDIHMA E SHPEJTË

Sipas ligjit shqiptar (Kodi i Punës, bazuar në nenin 65 dhe 75), çdo vend pune (përfshirë kishat) duhet të ketë një kuti të përshtatshme të ndihmës së shpejtë (dhe pajisje për fikjen e zjarrit). Kutia e ndihmës së shpejtë duhet të jetë e pajisur mirë dhe të kontrollohet në mënyrë periodike, për t'u siguruar se datat e pajisjeve sterilizuese/mjekimeve nuk kanë kaluar. Për një listë të tyre, shih shtojcën 4.5.

Ndihma e shpejtë duhet të administrohet nga një person i trajnuar, i cili mund të vlerësojë shkallën e lëndimit, dhe të vendosë nëse ka nevojë për mjekim të mëtejshëm/kujdes spitalor.

Ofruesi i ndihmës së shpejtë duhet të dokumentojë gjithmonë se çfarë veprimi u ndërмор, çfarë mjekimi u dha dhe çfarë është e nevojshme në vijim.

Rekomandohet që, gjatë dhënies së ndihmës së shpejtë, të jetë i pranishëm edhe një i rritur tjetër.

Bazuar në moshën dhe zhvillimin e fëmijës, të rriturit i inkurajojnë ata të bëjnë vetë lyejen me pomadë, krem dielli, të përdorin aparatin për marrjen e ilaçit të astmës etj., por gjithnjë me mbikëqyrje.

TUALETET

Stafi duhet të marrë masat e mëposhtme për të garantuar sigurinë, privatësinë dhe mirëqenien e fëmijëve kur përdorin tualetin:

- Fëmijët nuk duhen lënë kurrë vetëm në tualet. Një pjesëtar i stafit duhet të jetë në afërsi (mundësisht jashtë tualetit), që të ketë mundësi të ndërhyjë në rast se fëmija ka nevojë për ndihmë.
- Një pjesëtar i stafit dhe një fëmijë nuk duhet të qëndrojnë bashkë në tualet me dyer të mbyllura.
- Fëmijët ose të rriturit e cenusshëm që kanë nevojë për ndihmë kur përdorin tualetin mund të marrin ndihmë nga një person i caktuar i stafit me miratimin paraprak të prin-

dit/kujdestarit. Ndiham duhet dhënë në praninë e një pjesëtari tjetër të stafit dhe/ose me derën e tualetit jo plotësisht të mbyllur.

- Dy fëmijë nuk duhet të hyjnë njëkohësisht në të njëjtin tualet.
- Stafi duhet të sigurojë privatësinë e fëmijët/të rriturit të cenueshëm në çdo kohë.
- Kur grupi ndodhet në një vend ose zonë të panjohur, vajtja në tualet duhet bërë në grupe, për t'u siguruar që të gjithë fëmijët/të rriturit e cenueshëm janë të sigurtë.
- Ndërrimi i pelenave duhet bërë në një vend nga mund të shihet edhe prej një pjesëtari tjetër të stafit.

3.2 UDHËZIME RRETHANORE SPECIFIKE

MJEDISET REZIDENCIALE / KAMPET

Ndërrimi i veshjeve dhe larja

- Bëhet në mjedise ose kohë të ndryshme për djem/vajza, dhe duhet të mbikëqyren nga një i rritur i të një njëjtës gjini.
- Të rriturit nuk duhet të ndërrohen ose të lahen në të njëjtën kohë e të përdorin të njëjtat mjedise me fëmijët.
- Shmangni çdo kontakt fizik kur fëmijët nuk janë të veshur plotësisht, si p.sh., me rroba banje.
- Lajmëroni paraprakisht kur keni qëllim të hyni.

Mjediset e fjetjes

- Prindërit dhe fëmijët duhet të jenë tërësisht në dijeni për kushtet e mjediseve të fjetjes para udhëtimit.
- Djemtë dhe vajzat duhet të jenë në dhoma/çadra të ndara dhe çdo mbikëqyrës/kujdestar duhet të jetë i të njëjtës gjini.
- Fëmijët nuk duhet të ndajnë të njëjtin shtrat.
- Bëni kujdes kur është nevoja të qetësoni një fëmijë gjatë natës.

Ushqimi dhe pijet

- Rregulloret bazë të shëndetit dhe higjienës duhet të respektohen (nga punonjësit dhe fëmijët).
- Të gjitha ushqimet dhe pijet duhet të ruhen me kujdes.
- Ushqimet e vogla dhe vaktet duhet të jenë nën mbikëqyrjen e përshtatshme.
- Duhet të ketë ujë të pijshëm dhe të freskët në çdo kohë.

(Duhet patur parasysh që gjatë zhvillimit të aktiviteteve me fëmijë, mjedisi ku zhvillohet aktiviteti duhet të jetë brenda kushteve higjieno-sanitare të përcaktuara nga drejtorja e higjienës).

TRANSPORTI DHE ESKURSIONET

- Në çdo rast është i nevojshëm miratimi me shkrim i prindërve/kujdestarëve.
- Fëmijët duhet të transportohen me një mjet, të cilin autoritetet përkatëse e cilësojnë të sigurt (siguracioni i vlefshëm, kontroll teknik etj.).

- Drejtuesi i mjetit duhet të ketë patentë të vlefshme, të ketë miratimin e kishës, organizatës, agjencisë etj., që të dëshmojë se është drejtues mjeti i besueshëm, si dhe duhet t'u bindet ligjeve dhe rregullave të qarkullimit rrugor të vendit përkatës ku po udhëton.
- Fëmijët duhet të ulen në vende të përshtatshme për moshën e tyre, p.sh., jo të ulur në ndenjësen e parë, duhet të përdoren sisteme të përshtatshme fiksuese (karrike për fëmijët) dhe të përdoret rripi i sigurimit.
- Në pikat e nisjes ose zbritjes, drejtuesi i grupit të fëmijëve duhet të kontrollojë që nuk mungon asnjë fëmijë.



-4-

Burimet

4. BURIMET



4.1 LIDHJE TË DOBISHME:

Faqja e internetit e VUSh-it: www.vush.al

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen dhe të Drejtat e Fëmijëve: <http://femijet.gov.al/al>;

Lista Kombëtare e Njësive të Mbrojtjes së Fëmijës: <http://femijet.gov.al/al/wp-content/uploads/2016/10/Lista-NJMF.pdf>

Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve: <http://femijet.gov.al/al/konventa>

Udhëzim Për mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në rrezik për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës, nr. 10, datë 25.2.2015 http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/PDF-2015/33-2015.pdf;

Shërbimi Këshillimor i Kishave për Mbrojtjen e Fëmijës (CCPA): www.ccpas.co.uk

4.2 LIGJI SHQIPTAR:

Ligji mbi Mbrojtjen e të Drejtës së Fëmijës nr. 10 347, datë 4.11.2010

VKM nr. 263 dt. 12.04.2012 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme, për bashkëpunimin midis mekanizmave institucionalë dhe organizatave jo-fitimprurëse, për realizimin e politikave vendore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”

VKM nr. 265 dt. 12.04.2012 “Për krijimin dhe funksionimin e mekanizmit të bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve shtetërore përgjegjëse për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik , si dhe mënyrën e procedimit të tij” + Neni 8.

VKM nr. 267 dt. 12,04.2012 “Llojet, mënyra e shkëmbimit dhe përpunimit të informacionit dhe të të dhënave statistikore të kërkuara nga ASHMDF dhe nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor”

Kodi i Familjes (2003)

Ligji Nr. 9669 dt. 18 dhjetor 2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”

Kodi i Punës http://www.sociale.gov.al/files/userfiles/Kodi_i_punes-2012.pdf

Ndryshimet në Kodin e Punës 2015: https://www.parlament.al/wp-content/uploads/sites/4/2015/10/ligj_nr_136_dt_5_12_2015_25080_1.pdf

















Shqipëria është gjithashtu palë e një numri aktesh të Këshillit të Evropës të cilat lidhen me të drejtat e fëmijëve, duke përfshirë Konventën Evropiane mbi Veprimin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (16.5.2005);

Konventa mbi mbrojtjen e fëmijëve kundër shfrytëzimit seksual dhe abuzimit seksual (25.10.2007); dhe Konventa e Këshillit të Evropës “Për Parandalimin dhe Luftën e Dhunës Kundër Grave dhe Dhunës në Familje.”

4.3 GRAFIK RRJEDHËS I VEPRIMEVE PËR T'U NDËRMARRË NË RASTE TË MBROJTJES SË FËMIJËS



4.4 LISTA E ORGANIZATAVE DHE STREHAVE QË PUNOJNË ME VIKTIMAT E DHUNËS NË FAMILJE DHE NUMRAT FALAS TË LINJAVE NDIHMËSE

ORGANIZATA	QYTETI	KONTAKTI	
Rrjeti kundër dhunës gjinore dhe trafikimit	Tiranë		
			04 2233408
		@	
Shoqata “Refleksione”	Tiranë		Adresa: Rr. e Elbasanit, Pallatet “Fratari”, Tërshana 2, Kati i I-rë; Kutia Postare 2412/1
			04 2 340434
		@	refleksione@icc-al.org
Qendra e Këshillimit për Gra dhe Vajza	Tiranë		Adresa: Rr. “Sami Frashëri”, Pall.9, Shk.5, Kutia Postare 2416/1
			04 2 233408
		@	qkgv@albnet.net
Qendra për Nisma Ligjore Qytetare	Tiranë		Adresa: Rr. “Vaso Pasha”, Pall.12, Shk.1, Ap.1
			04 2 259795
		@	avokatore@albmail.com aurboz@yahoo.com
Qendra e të Drejtave të Njeriut në Demokraci	Tiranë		Adresa: Rr. “Siri Kodra”, Pall. 23, Shk. 1, Ap.12
			04 2 400712
		@	qdnd@albaniaonline.net info@hrdc.al
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim	Tiranë		Adresa: Rr. “Abdyl Frashëri”, Pall 10
			04 2 255514
		@	gadc@gadc.org.al
Të ndryshëm dhe të barabartë	Tiranë		Adresa: Rr. “Milito Tutulani”, Pall. Alb-Milenium, Shk. 6, Ap.30-34
			04 2221892
		@	different&equal@icc-al.org
Qendra Sociale për Gra dhe Vajza	Durrës		Adresa: Lagjja 11, Rr. “Baki Çelmeta” (pranë Restorantit “Pranvera”)
			052 2 223815
		@	shoqataegrave@yahoo.com

Forumi i Gruas Elbasan	Elbasan	 Adresa: Lagjja “5 Maji”, Rr. “Fetah Ekmeciu”, Pall.450/1
		 054 2 5 5509 054 2 540051
		 shoqataegrave@yahoo.com
Tjetër Vizion	Elbasan	 Adresa: Lagjja “Aqif Pasha”, Rr. “Ali Arapi”, Nr.19
		 054 2 252919
		 tjetervizion@gmail.com
Gruaja te Gruaja	Shkodër	 Adresa: Rr. “Marlin Barleti”, sipër Kristalit, përballë kinemasë “Millenium”
		 022 24 1154 022 24 5234
		 gruajatekgruaja@gmail.com
Qendra e Gruas “Hapat e Lehtë”	Shkodër	 Adresa: Rr. “Branko Kadia”, Lagjja “3 Heronjtë”, Nr. 57
		 022 44022
		 qendragruashk@yahoo.com
The Door	Shkodër	 Adresa: Lagjja “Naim Gjylbegu” Rruga “Bujar Bishanaku”
		 022 2 43729
		 thedoor@infothedoor.com
Qendra e Gruas “Kristal”	Berat	 Adresa: Pallati i Kulturës “Margarita Tutulani”
		 032 31 004
		 qkgv@yahoo.com
Ndihmë Sociale Gruas Kryefamiljare	Kuçovë	 Adresa: Lagjja “Llukan Prifti”
		 069 22 96 445
		 teftansgk@yahoo.com
Gruaja Korçare	Korçë	 Adresa: Bulevardi “Republika”, Pall. 3, A.1
		 082 43 563
		 korcawomen@yahoo.com
Shoqata “Unë Gruaja”	Pogradec	 Adresa: Rr. “Reshit Collaku”, Lagjja 1
		 083888140
		 une_gruaja@yahoo.com

NUMRAT FALAS TË LINJAVE NDIHMËSE

Emergjenca (Policia/Ambulanca/Zjarrfikësi):	112
Telefoni i ndihmës për fëmijë:	116-111
Numri i gjelbër i Bashkisë Tiranë (për dhunën në familje):	0800 0888

4.5 KUTIA E NDIHMËS SË SHPEJTË

Këto artikuj rekomandohen për një kuti të ndihmës së shpejtë me qëllim të përgjithshëm. Ju lutemi të këshilloheni për sa i përket përshtatshmërisë specifike për organizatën ose veprimtarinë tuaj.

Nr.	Artikulli	Njësia	Sasia
1	Listë me numrat e emergjencës	copë	1
2	HSE (12 x 12 cm) fashë mesatare në mbështjellje plastike sterile	copë	4
3	HSE (18 x 18 cm) fashë e madhe në mbështjellje plastike sterile	copë	1
4	Fashë elastike	copë	3
5	Garza sterile 5 x 5	copë	5
6	Garza sterile 7.5 x 7.5	copë	5
7	Garza sterile 10 x 10	copë	5
8	Garza syri, në mbështjellje plastike sterile	copë	5
9	Garza për djegie (10 x 10 cm) me hydrogel, jotoksik dhe nuk shkakton acarim	pako	1
10	Garza me antiseptik në mbështjellje individuale (pa alkool)	pako	1
11	Fashë trekëndore jo e endur për një përdorim (90 x 90 x 127)	copë	2
12	Fashë gishtërinjsh (3.5 x 3.5 cm) në mbështjellje plastike sterile	copë	2
13	Kompresë me ftohje të menjëhershme	copë	2
14	Pako me dhjetë fasha të ndryshme allçie që durojnë ujin	pako	4
15	Leukoplast (ngjitëse mikroporoze) (1.25 cm x 10 m)	copë	1
16	Ankeplast	pako	1
17	Doreza pa "latex"/pluhur nitrile	palë	2
18	Gërshërë e fortë pa majë	palë	1
19	Qese për mbetjet klinike	copë	1
20	Mbulesë termoizoluese (210 x 160 cm)	copë	2
21	Maskë për frymëmarrje gojë më gojë me valvul njëkalimshme	copë	1
22	Solucion fiziologjik për shpëlarjen e syrit	flakon	4
23	Manual për dhënien e ndihmës së parë	copë	1
24	Libër raportimi incidentesh/aksidentesh me formularë	copë	1

HIV/SIDA

Higjiena e mirë duhet të praktikohet gjithmonë. Kur trajtohet lëkura e çarë, lëngje trupore ose feçe, duhen përdorur doreza plastike dhe një përparëse.

Nëse përdorni ndonjë prej artikujve në kutinë e ndihmës së shpejtë, ju lutemi të siguroheni menjëherë për zëvendësimin e tyre. Kutia e ndihmës së shpejtë duhet të kontrollohet në mënyrë periodike.



-5-

**Formularë të gatshëm,
të dobishëm
për përdorim**

5.1 FORMULARI I INCIDENTEVE / AKSIDENTEVE

Shënoni këtu emrin e organizatës	
RAPORT INCIDENTEVE / AKSIDENTEVE	
<input type="checkbox"/> Incident	<input type="checkbox"/> Aksident
Emri i fëmijës/të rriturit të cënueshëm: _____	Data e aksidentit/incidentit: _____.____._____
Vendi ku ndodhi aksidenti/incidenti: _____	
Emri i anëtarit të stafit të pranishëm: _____	
Emrat e dëshmitarëve: _____	_____
Çfarë ndodhi? _____ _____ _____	
A kishte nevojë për përkujdesje mjekësore?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo
Nëse po, çfarë trajtimi mori fëmija/i rrituri i cënueshëm?	_____
Kush ia dha trajtimin fëmijës/të rriturit të cënueshëm?	_____
A ka nevojë për përkujdesje të mëtejshme mjekësore?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo
A u njoftua mbikëqyrësi?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo
A u njoftua prindi/kujdestari?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo
Nëse po, emri i personit që u njoftua?	_____
A nevojitet ndjekje e mëtejshme e rastit?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo
Nëse po, çfarë lloj ndjekjeje nevojitet?	_____ _____ _____
Shënoni emrin e personit që plotësoi raportin	Firma e personit që plotësoi raportin dhe data
_____	_____
Shëno emrin e mbikëqyrësit	Firma e mbikëqyrësit dhe data
_____	_____

5.2 FORMULARI I PRETENDIMIT

Ky formular duhet plotësuar në rast pretendimi ose nëse dyshohet për lëndim. Formulari i duhet dhënë personit të caktuar, përveçse nëse kjo nuk është e përshtatshme ose nëse personi i caktuar nuk është i disponueshëm. Në këtë rast, flisni me një drejtues të lartë ose kontaktoni shërbimet sociale.

FORMULARI I PRETENDIMIT	
Emri i fëmijës/i të rriturit të cenueshëm:	Mosha / Data e lindjes:
Emri i prindit/kujdestarët (emrat e prindërve):	Adresa / Nr. i telefonit:
Etnia e fëmijës:	Nevoja shtesë:
Çfarë e ka nxitur këtë shqetësim?	A është ky shqetësimi juaj apo i dikujt tjetër?
Shenja fizike?	Shenja në sjellje?
Shenja të tjera?	A është folur me fëmijën? Çfarë është thënë?
A janë kontaktuar fëmijët? Çfarë është thënë?	A është ngritur një pretendim mbi dikë si personi që ka shkaktuar lëndimin/abuzimin? Mbi kë?
A është marrë këshilla e dikujt tjetër? Emri:	Firma e personit që po jep këto të dhëna dhe data:

5.3 FORMULARI I REFERIMIT PËR MBROJTJEN E FËMIJËS

Ky formular përdoret kur bëhet një referim dhe plotësohet nga institucioni ose ofruesi i shërbimit i cili merr referimin, në lidhje me personin i cili bën referimin.

FORMULARI I REFERIMIT PËR MBROJTJEN E FËMIJËS		
Emri / Identiteti i fëmijës:	Mosha / Data e lindjes:	Gjinia:
Emri dhe adresa e kujdestarit parësor:	Vendndodhja e fëmijës (aty ku po rri fëmija):	
Shkolla:	Shërbime të tjera në lidhje me fëmijën (p.sh., shëndetësore etj.):	
Të dhëna mbi fëmijë të tjerë në shtëpi:		
Historik i shkurtër i familjes (nëse dihet):		
Arsyet për referim / Shqetësimi:		
Puna e bërë / Shërbimet e ofruara gjatë 7 ditëve të fundit:		
Emri dhe detajet e kontaktit të personit që bën referimin:	Emri dhe detajet e kontaktit të personit që merr referimin:	Data kur është bërë referimi:

5.4 FORMULAR MIRATIMI PËR FËMIJËN

FORMULAR MIRATIMI PËR FËMIJËN / TË RRRITURIN E CENUESHËM			
Emri i plotë:	_____		
Adresa:	_____		
Nr. i telefonit:	_____	Kontakt shtesë:	_____
Data e lindjes:	_____	Nevoja të veçanta	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo
Shkolla:	_____		
Detaje të ndonjë problemi mjekësor që duhet ta dimë:	_____ _____		
Data e vaksinimit të fundit kundër tetanozit:	_____		
<p>Unë jap lejen që fëmija im/nën kujdestarinë time _____ të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet normale të _____. Unë e kuptoj se për ekskursionet ditore dhe aktivitete të tjera të ngjashme mund të nevojitet miratim shtesë. Unë pranoj ta informoj personin përgjegjës për çdo ndryshim të detajeve personale, si adresa dhe kushtet mjekësore. Unë e kuptoj se ndaj fëmijës tim do të ushtrohet i gjithë kujdesi i arsyeshëm, por stafi nuk mund të mbahet detyrimisht përgjegjës për çdo humbje, dëmtim ose lëndim që fëmija im pëson gjatë një aktiviteti. Unë pranoj se stafi nuk është përgjegjës për artikuj personal si: telefonat celularë, lojëra elektronike, sende me vlerë etj. Unë e kuptoj se fëmijës tim do t'i kërkohet të ndjekë rregullat e grupit dhe të sillet në mënyrë të përshtatshme.</p>			
<p>Unë bie dakort që fotografitë e fëmijës tim të përdoren në _____ reklama ose publikime.</p>			
Ju lutem shënoni:	<input type="checkbox"/> Po	<input type="checkbox"/> Jo	
<p>Nëse ndodh një rast emergjence dhe kontakti me mua nuk është i mundur, unë pranoj që fëmija im të marrë trajtim spitalor ose dentar.</p>			
Ju lutem shënoni:	<input type="checkbox"/> Po	<input type="checkbox"/> Jo	
Data:	_____		
Firma (Prindi/kujdestari ligjor):	_____		

5.5 FORMULARI PËR STAF DHE VULLNETARË

FORMULARI PËR STAF DHE VULLNETARË		F. 1/2
Emri:	_____	
Adresa:	_____	
Nr. i telefonit:	_____ E-mail: _____	
Data e lindjes:	_____	
Përvoja e mëparshme e punës me fëmijët (përfshini trajnimet dhe kualifikimet):		

A keni marrë pjesë më parë në punë vullnetare? <input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo		
Nëse po, ju lutemi të jepni detaje.		

Me cilat grupe brenda kishës jeni të interesuar të përfshihen? Ju lutemi shënoni:		

Ju lutemi të na tregoni për përvojën tuaj të krishterë (prej sa kohësh jeni i krishterë, në cilat kisha keni marrë pjesë dhe datat) Ju lutemi të përfshini emrat e drejtuesve:		

A keni ndonjë interes që e ndiqni në kohën tuaj të lirë?		

Ju lutemi të jepni emrat dhe adresat e dy personave që mund të kontaktojmë si referencë (jo të afërmit tuaj):

Emri: _____ Emri: _____

Adresa: _____ Adresa: _____

Telefon: _____ Telefon: _____

A jeni dënuar ndonjëherë për ndonjë veprë penale? Po Jo

Nëse Po, ju lutemi të shtjelloni më poshtë natyrën dhe datën (datat) e veprës (veprave) penale.

A keni qenë subjekt i një mase paralajmëruese ose shtrënguese? Po Jo

Nëse Po, ju lutemi shtjelloni më poshtë natyrën dhe datën (datat) e masës (masave) parandaluese.

A ju është refuzuar ndonjëherë më parë ofrimi juaj për të punuar me fëmijët/të rinjtë?

Po Jo

Nëse Po, ju lutemi jepni detajet:

A pranoni të dorëzoni dëshminë e penalitetit? Po Jo

Data: _____

Firma: _____